



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 280 Akti

Nr. 346 Vendimi
Tiranë, më 16.2.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Olsi Komici	Relator
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datën 9.2.2021, ora 9.30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Marjeta Zaimi**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila kërkoj konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Marjeta Zaimi, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Marjeta Zaimi, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Marjeta Zaimi, ushtron detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtuar rivlerësimit *ex officio*, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

2. Subjekti i rivlerësimit iu është nënshtuar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.3.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Olsi Komici dhe Firdes Shuli. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Olsi Komici.

3. Me vendimin nr. 1, datë 21.3.2019, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Marjeta Zaimi, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi si kryesues të trupit gjykues komisioneren Firdes Shuli. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Branko Hrvatin.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim, Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, DSIK) dhe Grupi i Punës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.

5. Në vijim, nga relatori i çështjes, janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme, për këtë procedurë rivlerësimi.

6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 19.11.2020, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Marjeta Zaimi, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47, të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 19.11.2020, mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

8. Subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike në datën 19.11.2020, ka njoftuar Komisionin se është hospitalizuar në gjendje të rëndë shëndetësore për shkak të diagnozës “pneumoni e rëndë shkaktuar nga COVID -19”, i është rekomanduar regjim shtrati dhe i është dhënë raport për paaftësi të përkohshme në punë deri në datën 12.1.2021, duke e bashkëngjitur atë.

9. Komisioni, me anë të postës elektronike në datën 7.12.2020, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit se ka vendosur të pranojë kërkesën për shtyrje dhe t’i japë kohë për kthimin e përgjigjeve dhe paraqitjen e provave mbi rezultatet e hetimit deri në datën 19.1.2021.

10. Subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike në datën 19.1.2021, ka dërguar prapësimet dhe dokumentacionin bashkëngjitur për rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni.

II. SEANCA DËGJIMORE

10. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë elektronike nga Komisioni në datën 2.2.2021.

11. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 9.2.2021, ora 11:30, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe parashitroi shpjegimet e tij në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë trupit gjykues.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, znj. Marjeta Zaimi, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

12. Znj. Marjeta Zaimi ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

13. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

14. Për subjektin e rivlerësimit, znj. Marjeta Zaimi, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

15. Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

16. Me shkresën nr. *** prot., datë 20.9.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Marjeta Zaimi, e cila është subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së që prej vitit 2003, me numër indeksi ***, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

17. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave privatë nga viti 2003 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë - shtojca 2, në datën 26.1.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për çdo pasuri të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje pasurie;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

18. Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- b) deklaratën e pasurisë - shtojca 2 dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite;
- c) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet, të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016;
- e) deklarime dhe prova të dërguara nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- f) shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore.

19. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim verifikimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të pasurive në pronësi apo përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me dorëzimin e deklaratës së pasurisë - shtojca 2, në zbatim të nenit 31/1¹, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Marjeta Zaimi, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë edhe personat e lidhur me të), në bazë të ligjit nr. 84/2016, në datën 26.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

➤ Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting

1. Depozitë në BKT, krijuar në datën 25.10.2010 në vlerën 1,000,000 lekë dhe gjendje më 26.1.2017. Vlera: 8014.53 euro. Pjesa takuese: 50%.

Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: (i) një pjesë e depozitave të tërhequra në vitet 2009 – 2010; dhe (ii) kursimet nga paga, të deklaruara në deklarin e pasurisë në vitin 2010.

Subjekti ka shtuar në këtë deklaratë se në datën 6.8.2012 depozita konvertohet në euro në shumën 7,846.10 euro dhe në datën 23.12.2015 kjo depozitë kthehet në depozitë dyemërore (+ interesat ndër vite).

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

1.1 Nga BKT-ja² është konfirmuar gjendja e depozitës në datën 23.1.2017, në shumën 8,014.53 euro. Kjo depozitë, e gjeneruar nga depozitat e mëparshme, është krijuar fillimisht në datën 26.10.2010 me depozitim *cash* të shumës 1,000,000 lekë nga bashkëshorti i subjektit, e cila në datë 6.8.2010 ka arritur vlerën 1,077,662.15 lekë. Shuma prej 1,077,662.15 lekësh është konvertuar në monedhën euro, duke krijuar depozitën në shumën 7,846.10 euro, në emër të bashkëshortit, në datën 6.8.2012, depozitë kjo e mbyllur, më pas, në datën 23.12.2015, në vlerën 8.000.97 euro. Me transferimin e shumës 8,000.97 euro në llogarinë dyemërore, është hapur në datën 23.12.2015 në emër të B. dhe Marjeta Zaimi depozita me afat njëvjeçar, e cila në datën 23.1.2017 ka arritur në vlerën 8,014.53 euro.

1.2 Në lidhje me burimin e krijimit të depozitës në shumën 1,000,000 lekë, subjekti në deklaratën periodike (DIPP në vijim) të vitit 2010 ka deklaruar si burim: “... një pjesë e depozitës së tërhequr në vitin 2009 e të deklaruar në deklarin e vitit 2010”.

1.3 I pyetur nga Komisioni³ lidhur me datën e saktë të kryerjes së tërheqjes, bankën ku është kryer veprimi i tërheqjes, shumën e tërhequr dhe shumën e përdorur prej tij (pjesën) si burim për krijimin e depozitës në datën 26.10.2010, subjekti ka shpjeguar se: “*Depozitë e tërhequr më 4.11.2008, nga Tirana Banka prej bashkëshortit tim B.Z. në vlerën 1.662.600 lekë, prej së cilës për krijimin e depozitës së çelur në BKT në emër të bashkëshortit tim është përdorur shuma e mbetur prej*

¹ Subjekti i rivlerësimit ka detyrim të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon në ILDKPKI.

² Shkresë nr. *** prot., datë 17.2.2020, e BKT-së.

³ Shihni pyetësorin nr. 2.

662,600 lekësh së bashku me diferencën e mbetur nga pjesa e të ardhurave cash të mbetura nga shitja e banesës, e deklaruar si pjesë e gjendjes cash në vitin 2009 (shihni përgjigjen e pyetjes nr. 8 të këtij pyetësori)”.

1.4 Në DIPP-në e vitit 2008, në faqen 4, te rubrika “të ardhurat dhe angazhimet“, subjekti ka deklaruar: “*Depozitë e tërhequr nga Tirana Bank në datën 31.10.2008, në vlerën 1,662,690 lekë*”, dhe në po të njëjtën faqe deklaroi: “ *...1,500,000 lekë të ardhura cash, një pjesë e kontratës paraprake të shitjes*”.

1.5 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP e vitit 2008, shumën prej 1,662,600 lekësh, si depozitë e tërhequr në “Tirana Bank” në datën 31.10.2008, por nuk e ka deklaruar këtë shumë si kursim *cash*, në vitin 2008.

1.6 Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe në seancën dëgjimore, ka shpjeguar se u qëndron shpjegimeve se në DIPP-në e vitit 2008 gjendja *cash* është deklaruar në faqen *** të kësaj deklarates e ndarë sipas burimit të krijimit: (a) shuma 1,500,000 lekë nga një pjesë e kontratës paraprake të shitjes; dhe (b) shuma 1.662.600 lekë nga tërheqja e depozitës në “Tirana Bank” në datën 31.10.2008.

Subjekti shpjegon, gjithashtu, se gjatë viteve 2008 – 2010, meqenëse kishin prioritet blerjen e një banese, familjarisht kanë kryer vetëm shpenzimet e domosdoshme. Për këtë arsye, depozita e tërhequr në datën 31.10.2008, në shumën 1,662,690 lekë, nga “Tirana Bank” ka qenë e paprekur si gjendje *cash* në banesë dhe është deklaruar në DIPP-në e vitit 2008.

1.7 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me deklarimin e gjendjes *cash* për vitin 2008, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti, pavarësisht se nuk ka deklaruar tërheqjen e depozitës si burim të kursimeve *cash*, ka deklaruar tërheqjen e saj në datën 30.10.2008, duke argumentuar se gjendja e lartë *cash* nevojitej nëse do të ofrohej mundësia për blerjen e apartamentit, blerja e të cilit ishte prioritet në momentin, ku sapo ishin transferuar nga qyteti i Fierit. Shuma prej 1,662,690 lekësh e tërhequr nga banka më 30.10.2008, pasqyrohet si e tillë dhe e paprekur deri më 31.12.2008, që është data e fundit e pasqyrimit të ndryshimeve, shtesa dhe pakësime të pasurisë që deklarohet për vitin përkatës, veprime këto të ndodhura në një periudhë të shkurtër kohore, dy mujore. Gjithashtu nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk rezultoi që deri në fund të vitit të ketë krijuar ndonjë pasuri tjetër, ku të jetë përdorur shuma e depozitës së tërhequr. Edhe gjendja *cash* prej 3,500,000 lekësh e deklaruar në DIPP-në e vitit 2009 krijon bindjen se gjendja *cash* në vitin 2008 është në shumën 3,162,600 lekë.

Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me situatën e gjendjes *cash* në datën 31.12.2008, të deklaruar në DIPP-në e vitit 2008.

2. Llogari bankare page në “Credins Bank”, me gjendje në datën 26.1.2017, në shumën 85.2 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga.

3. Llogari bankare në euro, në “Raiffeisen Bank”, çelur në datën 24.6.2008, me vlerë zero euro

“Credins Bank”⁴ konfirmon llogarinë e pagës në emër të subjektit të rivlerësimit me gjendje në datën 26.1.2017, në vlerën 85.2 lekë dhe “Raiffeisen Bank”⁵ konfirmon llogarinë me nr. ***, me gjendje 0 (zero) euro.

Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me dy llogaritë bankare në pikat 3 dhe 4, sipërcituar, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në shumat 85.2 lekë dhe 0 (zero) euro.

4. Të ardhura në shumën 480 euro, të përfituara nga pjesëmarrja në trajnimet e zhvilluara në vitin 2010, në Beograd, Jugosllavi dhe Vjenë, Austri

5. Të ardhura në shumën 1,405 USD, të përfituara nga pjesëmarrja në trajnimin e zhvilluar me ftesë të DASH-it në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Shumat 480 euro dhe 1,405 USD⁶ janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike përkatëse. Subjekti ka depozituar dokumentacion për pjesëmarrjen në trajnime, mbulimin e shpenzimeve të akomodimit dhe të udhëtimit nga organizatorët, si dhe përfitimin e dietave të pjesshme nga Prokuroria e Përgjithshme.

Komisioni nuk konstatoi problematika, në lidhje me deklarimin e të ardhurave nga trajnimet, të pasqyruara në pikat 4 dhe 5, sipërcituar. Në analizën financiare këto të ardhura nuk janë marrë në konsideratë, pasi janë përdorur për të mbuluar shpenzimet e akomodimit, të udhëtimit dhe të qëndrimit gjatë trajnimit të zhvilluar.

6. Kredi në BKT, në datën 9.6.2011, në shumën 5,000,000 lekë, me interes 4% me afat maturimi 240 muaj. Në datën 26.1.2016 ka mbetur pa paguar principal shuma 3,987,340.48 lekë + interesa.

6.1 Kjo kredi është deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2011, si vijon: *“Marrë kredi për blerje shtëpie në BKT në datën 7.6.2011, në shumën 5,000,000 lekë me interes 4% me afat maturimi 240 muaj (20 vjet)... Mbetur pa paguar principal 4,908,536 lekë+interesa 2,138,436 lekë”*.

6.2 Subjekti ka depozituar kontratën e kredisë bankare, datë 2.6.2011⁷, me kredihënës BKT dhe kredimarrës Marjeta Zaimi, me dorëzanës shtetasit B.Z. dhe P.B., si dhe shoqërinë “****” sh.p.k., ku subjektit i është akorduar kredia në shumën 5,000,000 lekë.

Kredia është dhënë në bazë të legjislacionit në fuqi⁸, me afat shlyerjeje 20 vjet. Sigurimi i kredisë do të bëhet nga hipotekimi i pasurisë së paluajtshme “apartament”, me sip.103 m², në Selitë, Tiranë, regjistruar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.

⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 18.2.2020, e “Credins Bank”.

⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 22.5.2020, e “Raiffeisen Bank”.

⁶ Subjekti ka deklaruar në deklaratën e vitit 2010: *“Të ardhura të përfituara nga pjesëmarrja në procese trajnimi në Beograd-Jugosllavi dhe Vjenë - Austri” në shumën 480 euro; në deklaratën periodike të vitit 2011 subjekti ka deklaruar: “Të ardhura të përfituara nga Departamenti Amerikan i Shtetit nga pjesëmarrja në procese trajnimi në USA në vlerën 1405 USD”*.

⁷ Kontrata e kredisë bankare nr. ***, datë 2.6.2011, me BKT-në për dhënien e kredisë 5,000,000 lekë.

⁸ Ligji nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane i ndryshuar”, VKM-ja nr. 600, datë 12.9.2007 “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”. Udhëzimit nr. ***, datë 2.9.2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”; si dhe udhëzimit nr. ***, datë 17.10.2008 “Për përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”.

Gjithashtu, subjekti ka depozituar dhe kontratën e hipotekimit, datë 4.4.2011⁹, me hipotekues shoqërinë “***” sh.p.k. dhe shtetasin P.B. dhe kreditor BKT, për vënien në hipotekë të apartamentit me sip. 103 m², ndodhur në S., Tiranë.

6.3 Komisioni ka analizuar përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese dhe ka administruar dokumentacionin përkatës nga BKT-ja,¹⁰ si vijon: (i) marrëveshja tripalëshe e lidhur ndërmjet BKT-së, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, sipas së cilës bëhet i mundur zbatimi dhe implementimi i programit për subvencionimin në favor të familjeve që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti; (ii) shkresën e Prokurorisë së Përgjithshme e vitit 2010¹¹ ku i dërgon BKT-së listën e prokurorëve që përfitojnë kredi për strehim, ku subjekti Marjeta Zaimi rezulton në listë me numër rendor 1 dhe përfiton vlerë kredie në shumën 5,000,000 lekë, në bazë të pikës 10 të VKM-së nr. 600/2007¹². Kjo VKM ka përcaktuar në pikën 2 të saj se: *“Të gjitha subjekteve të përcaktuara në pikën 1 [.....], kur kanë nevojë për strehim a sipërfaqe banimi shtesë, u lind e drejta të kërkojnë trajtim, me kredi, me kushte lehtësuese, nga shteti, për blerje banese apo sipërfaqe shtesë banimi, në vendin e ushtrimit të detyrës”*.

Ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti B.Z. nuk kanë pasur në pronësi të tyre banesë tjetër apo banesë me sipërfaqe nën normat e strehimit për banor. Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë pasur një banesë në bashkëpronësi në qytetin e Fierit, të cilën e kanë shitur në vitin 2008. Nga qershor 2008 – tetor 2011, subjekti i rivlerësimit bashkë me personin e lidhur/bashkëshortin B.Z. kanë jetuar në apartamentin e vëllait të bashkëshortit, z. A.Z., i cili jeton dhe punon në Greqi. Për periudhën 1.6.2008 – 1.6.2010, kanë jetuar me qira në këtë apartament me 15,000 lekë/muaj, ndërsa për periudhën nga 1.6.2010 deri në blerjen apartamentit të tyre, në tetor të vitit 2011 kanë jetuar pa qira.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Marjeta Zaimi dhe personi i lidhur/bashkëshorti B.Z. kanë përfituar kredi me kushte lehtësuese nga BKT-ja, në përputhje me VKM-në nr. 600, datë 12.9.2007.

Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me kredinë e përfituar me kushte lehtësuese nga subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti.

PERSONI I LIDHUR ME SUBJEKTIN/BASHKËSHORTI B.Z.

7. Blerje apartamenti me sip. 103 m², në z. k. *, në Selitë, Tiranë, regjistruar në emrin të bashkëshortit të subjektit, z. B.Z. Kontratë shitblerjeje me rezervë e pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 22.4.2011. Vlera: 87,750 euro. Pjesa takuese: 100%.**

⁹ Kontratë hipotekimi nr. ***, datë 4.4.2011.

¹⁰ BKT-ja me nr. *** prot., datë 27.5.2020 dhe me e-mail-in e datës 29.5.2020.

¹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 28.10.2010, e Prokurorisë së Përgjithshme.

¹² VKM-ja nr. 600/2007 “Për trajnimin me strehim të nëpunësve civile të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë” në pikën 1 përcakton se: *“Në kuptim të këtij vendimi me funksionarë politikë dhe nëpunës civilë të administratës së lartë shtetërore, që trajtohen me strehim, nënkuptohen: (c) Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm”*. Në pikën 2 të kësaj VKM-je përcaktohet: *“Të gjitha subjekteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, gjatë kohës së ushtrimit të detyrës apo të funksionit shtetëror, të sipërpërmendur, kur kanë nevojë për strehim a sipërfaqe banimi shtesë, u lind e drejta të kërkojnë trajtim, me kredi, me kushte lehtësuese, nga shteti, për blerje banese apo sipërfaqe shtesë banimi, në vendin e ushtrimit të detyrës, që, në kuptim të këtij vendimi nënkupton territorin e rrethit, ku ndodhet selia administrative e organit, ku subjekti kryen funksionin a ushtron detyrën”*.

Personi i lidhur me subjektin/bashkëshorti ka deklaruar si burimi i krijimit: (a) kredi në BKT në shumën 5,000,000 lekë marrë prej bashkëshortes; (b) pakësuar pasuria e luajtshme, tërhequr depozitat në “Raiffeisen Bank”, në shumën 2,498,714 lekë, në “Intesa Sanpaolo Bank”, në shumën 646,749 lekë dhe “Credins Bank”, në shumën 845,882 lekë; si dhe (c) pakësimi i gjendjes *cash* në shumën 2,494,000 lekë (gjithsej, në shumën 6,485,000 lekë, të deklaruar në deklaratimet vjetore të pasurive+interesat bankare të deklaruara më parë), në këtë shumë janë përfshirë edhe të ardhurat nga shitja e apartamentit në Fier me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 2.6.2009, deklaruar në deklaratimet vjetore të pasurisë.

7.1 Kjo pasuri është deklaruar në DIPP-në e vitit 2011, si vijon: *“Blerje apartamenti me sipërfaqe 103 m², në z. k. ***, S., Tiranë, me kontratë shitblerje me rezervë nr. ***, datë 22.4.2011. Burimi i krijimit: kredi në BKT në shumën 5,000,000 lekë. Pakësuar pasuria e luajtshme. Tërhequr depozitat në ‘Raiffeisen Bank’ në shumën 2,498,714 lekë, ‘Intesa Sanpaolo Bank’ në shumën 646,749 lekë dhe në ‘Credins Bank’ në shumën 845,882 lekë, si dhe pakësimi i gjendjes cash, në shumën 2,494,000 lekë, gjithsej në shumën 6,485,000 lekë”.*

7.2 Subjekti ka depozituar: (i) kontratën e shitblerjes me rezervë, datë 22.4.2011¹³, me shitës shoqërinë “***” sh.p.k. me administrator P.B. dhe blerës B. dhe Marieta Zaimi, për blerjen e apartamentit me sip.103 m²¹⁴, në S., Tiranë. Në kontratë është parashikuar se çmimi i apartamentit është 87,750 euro dhe do të likuidohet në llogarinë bankare të shitësit. Kalimi në favor të palës blerëse do të bëhet pasi të plotësohet rezerva ligjore, pra, kur pala blerëse t’i paguajë palës shitëse të gjithë vlerën e kontratës së pasurisë së paluajtshme. Afati përfundimtar i likuidimit do të jetë 30 ditë pas nënshkrimit të kësaj kontrate; (ii) certifikatë pronësie, datë 17.2.2011, për apartamentin me sip. 103 m², në S., Tiranë, në emër të shoqërisë “***” sh.p.k; dhe (iii) certifikatë pronësie, datë 12.7.2011, për të njëjtin apartament në emër të shtetasit B.Z.

7.3 ASHK-ja Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1¹⁵ ka konfirmuar regjistrimin në emër të shtetasit B.Z. të pasurisë “apartament” me sip. 103 m², nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, përfituar nga kontrata e shitblerjes me rezervë e apartamentit, datë 22.4.2011.

ASHK-ja ka depozituar dhe deklaratën noteriale, datë 29.6.2011¹⁶, në të cilën shoqëria “***” sh.p.k. deklaron se me shtetasit B. dhe Marjeta Zaimi kanë lidhur kontratën e shitjes me rezervë në datën 22.4.2011, kanë bërë likuidimin total të vlerës së blerjes, si dhe nuk kanë detyrime dhe pretendime ndaj tyre. Po kështu, deklarojnë edhe shtetasit B. dhe Marjeta Zaimi, që kanë bërë likuidimin total të vlerës së blerjes së apartamentit, si dhe nuk kanë detyrime ndaj njëri-tjetrit.

7.4 Komisioni ka analizuar çmimin e blerjes së këtij apartamenti, duke e krahasuar me çmimin referues sipas EKB-së për vitin 2011¹⁷, i cili përcakton se çmimi i apartamenteve në tregun e lirë për qytetin e Tiranës për zonën 6, ku përfshihet zona e Selitës pas llogaritjes do të ishte në shumën

¹³ Kontratë e shitblerjes me rezervë nr. ***, datë 22.4.2011.

¹⁴ Apartamenti me sip.103 m², nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***.

¹⁵ ASHK-ja Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1 me nr. *** prot, datë 22.7.2020.

¹⁶ Deklarata noteriale nr. *** rep., datë 29.6.2011, me deklarues shoqërinë “***” sh.p.k. dhe shtetasit B. e Marjeta Zaimi.

¹⁷ Sipas udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011, për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2011, EKB-ja përcakton se çmimi i apartamenteve në tregun e lirë për qytetin e Tiranës për zonën *** ku përfshihet zona e S. përcakton si çmim 70,000 lekë/m² dhe po të llogarisim 103 m² x 70,000 lekë = vlera totale 7,210,000 lekë (ose me kursin ditor të euros me 141.57 lekë) ose 50,925 euro. Nëse do merrej për referencë zonës së S. së V. që është nr. ***, përcaktohet si çmim 95,000 lekë/m² dhe po të llogaritej sipërfaqja me 103 m² x 95,000 lekë = vlera totale 9,785,000 lekë ose 69,117 euro. Rezulton se subjekti e ka blerë apartamentin me çmimi më të lartë se çmimi referues i EKB-së.

7,210,000 lekë ose 50,925 euro¹⁸, ndërsa nëse do të merrej për referencë zona 5, S. e V., vlera do të ishte 9,785,000 lekë ose 69,117 euro. Rezulton se subjekti e ka blerë apartamentin me çmim më të lartë se çmimi referues i EKB-së.

7.5 Në DIPP-në e vitit 2011 dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti deklaroi si shumë të paguar për blerjen e apartamentit vlerën prej 11,485,285 lekësh, respektivisht: 5,000,000 lekë paguar me kredinë e marrë në BKT; 2,498,714 lekë tërhequr depozitat në “Raiffeisen Bank”; 646,749 lekë tërhequr depozitat në “Intesa Sanpaolo Bank”; 845,822 lekë tërhequr depozitat në “Credins Bank”; dhe 2,494,000 lekë pakësuar gjendja *cash*.

7.6 Drejtorja e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)¹⁹ konfirmon veprimin bankar, datë 22.6.2011, të pagesës së vlerës prej 23,000 euro nga znj. Marjeta Zaimi për llogari të shoqërisë “***” sh.p.k., me përshkrimin “për blerje apartamenti”, në BKT.

7.7 E pyetur nga Komisioni²⁰, për të provuar me dokumentacion ligjor pagesat që i janë bërë shoqërisë “***” sh.p.k për blerjen e apartamentit në vlerën 87,750 euro, subjekti fillimisht ka shpjeguar se si burim për blerjen e tij kanë shërbyer: (a) shuma 2,500,000 lekë (për krijimin e së cilës ka shërbyer pakësimi i gjendjes *cash*), kaluar në favor të shoqërisë “***” sh.p.k. në datën 8.6.2011; (b) shuma 5,000,000 lekë (kredia e marrë në BKT), kaluar në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., në datën 9.6.2011; (c) shuma 1,200,000 lekë (depozita në “Raiffeisen Bank”, në emër të subjektit), kaluar në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., në datën 20.10.2011; (ç) shuma 646,749 lekë, tërhequr nga “Intesa Sanpaolo Bank”; shuma 845,822 lekë, tërhequr nga “Credins Bank”; si dhe shuma 1,249,000 lekë tërhequr nga “Raiffeisen Bank”.

7.8 Me shpjegimet shtesë të dhëna për pyetësin nr. 2, subjekti i rivlerësimit saktëson se: *“Në datën 22.6.2011 ka kaluar në favor të shoqërisë ‘***’ sh.p.k. shuma prej 23,000 euro (veprim i cili nuk më kujtohej dhe nuk disponoja asnjë dokument për kryerjen e tij, pasi ka qenë derdhje në bankë për llogari të shoqërisë), por si burim i kësaj shume kanë shërbyer ndihma e dhënë prej familjarëve të mi 8,000 euro dhe 250,000 lekë, pakësimi i gjendjes cash të deklaruar si dhe kursimet nga pagat tona deri në maj 2011. Konkretisht, më ka ndihmuar vëllai dhe motra ime, D.G..., më ka ndihmuar me shumën 4,000 Euro dhe E.B..., më ka dhënë shumën prej 250,000 lekësh ..., si dhe të afërmit e bashkëshortit tim, vëllai i tij S.Z..., më ka ndihmuar me shumën 2,000 euro dhe motra A.Sh. ...me 2,000 euro. Këtë fakt e kam deklaruar edhe në vitin 2016, kur jam pyetur prej inspektorit të ILDKPKI-së. Duke qenë se sqarimet e dhëna prej meje në pyetësin nr. 2, te pyetja nr. 2, kanë qenë konfuze për shkak të mungesës së dokumentacionit të plotë....prej meje është shpjeguar se për shlyerjen e kësaj vlere kanë shërbyer si burim krijimi depozitat e ndodhura në ‘Credins Bank’, ‘Intesa Sanpaolo Bank’ dhe ‘Raiffeisen Bank’, të çelura në emër të bashkëshortit. Por në fakt këto depozita nuk kanë shërbyer në mënyrë të drejtpërdrejtë në blerjen e apartamentit, por në mënyrë indirekte, pasi me shumën e tërhequra janë shlyer ndihmat e dhëna prej familjarëve tanë për të cilat nuk kemi hartuar dokumentacion ligjor”.*

7.8.1 Subjekti ka depozituar dhe deklaratën noteriale, datë 24.4.2020, me deklarues shoqërinë “***” sh.p.k. dhe shtetasit B. dhe Marjeta Zaimi, në të cilën deklaruesi P.B. në cilësinë e administratorit deklaroi se: *“B.Z. dhe Marjeta Zaimi e kanë likuiduar plotësisht vlerën e*

¹⁸ Llogaritur me kursin ditor të euros me 141.57 lekë nga Banka e Shqipërisë.

¹⁹ DPPPP me nr. *** prot., datë 22.5.2020.

²⁰ Shihni pyetësin nr. 2.

*apartamentit të blerë prej tyre, likuidim i cili është bërë në periudhën qershor 2011 – dhjetor 2011, shuma të cilat kanë kaluar nëpërmjet bankës në llogarinë e shoqërisë “***” sh.p.k”.*

Gjithashtu, në deklaratën noteriale, datë 2.6.2011²¹, shtetasit B.Z., Marjeta Zaimi dhe P.B., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., deklarojnë se palët kanë rënë dakord që pagesën prej 87,750 euro do ta kryejnë duke lëvruar kredinë prej 5,000,000 lekësh pranë BKT-së, pjesa e shumës prej 2,500,000 lekësh do të paguhet nga llogaria bankare e znj. Marjeta Zaimi, pranë BKT-së në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., menjëherë me kalimin e kredisë, ndërsa pjesa tjetër e shumës së mbetur do të paguhet nga pala blerëse te pala shitëse shoqëria “****” sh.p.k., jashtë zyrës noteriale brenda datës 30.6.2011, duke ndryshuar kështu edhe afatin e pagesës përfundimtare që është përcaktuar në kontratë.

7.9 Komisioni ka administruar dokumentacionin e vënë në dispozicion nga shoqëria “****” sh.p.k.,²² si vijon: (i) kontratë shitblerje me rezervë²³ me blerës shtetasit B. dhe Marjeta Zaimi, për blerje apartamenti me sip. 103 m² me çmimin 87,750 euro; (ii) deklaratë noteriale, datë 2.6.2011, ku deklarohet mënyra e pagesës, si dhe ndryshimi i afatit të pagesë së përcaktuar në kontratën e shitjes (brenda datës 30.6.2011); (iii) deklaratë noteriale, datë 24.4.2020, ku deklarohet se është likuiduar plotësisht vlera e apartamentit; (iv) nxjerrja e llogarive bankare në BKT²⁴ e shoqërisë “****” sh.p.k., ku pasqyrohen shumat: (1) 2,500,000 lekë, transferuar nga znj. Marjeta Zaimi pagesë kapari për blerje apartamenti, datë 8.6.2011; (2) 5,000,000 lekë, transferuar nga znj. Marjeta Zaimi, pagesë për blerje apartamenti, datë 9.6.2011; (3) 23,000 euro, znj. Marjeta Zaimi, derdh në llogari për blerje apartamenti; (v) nxjerrja e llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank” e shoqërisë “****” sh.p.k., ku pasqyrohet shuma 1,200,000 lekë, datë 20.10.2011, transferuar nga znj. Marjeta Zaimi për pagesë kësti për blerje shtëpie; (vi) kontratë shitblerje, datë 7.2.2012, me shitës shoqërinë “****” sh.p.k., dhe blerës znj. V.B., të pasurisë apartament, me sip. 91.3 m², nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, ndodhur në S., Tiranë, me çmimin 71,000 euro.

7.10 Në procesverbalin e datës 18.4.2016 mbajtur në ILDKPKI, kur është pyetur për mungesën e mundësisë financuese për blerjen e apartamentit, subjekti ka shpjeguar se: *“Fillimisht dua të sqaroj se shuma e paguar për blerjen e banesës nuk ka qenë 12,191,107 lekë sipas kursit tuaj, por ka qenë 11,485,000 lekë, ku konvertimi është bërë prej pronarit të firmës dhe i korrespondon shifrës prej 87,750 euro, kjo pasi vlera e këmbimit ka qenë e ndryshme gjatë vitit 2011. Ne, pagesat e këtij apartamenti i kemi bërë duke kaluar nëpërmjet depozitave tona te llogaria e shoqërisë “****” sh.p.k., duke paguar respektivisht shumat 2,498,714 lekë të cilat kanë qenë në ‘Raiffeisen Bank’, depozita në ‘Intesa Sanpaolo Bank’ në shumën 646,749 lekë, depozita në “Credins Bank” në shumën 845,882 lekë dhe vlera prej 2,494,000 e cila ka qenë gjendje cash prej 950,000 lekë dhe afërsisht 1,600,000 lekë ndihma e familjarëve të mi të cilët janë, dy vëllezërit e bashkëshortit A. dhe S. (A.) Z. emigrantë në Greqi, motra e bashkëshortit A.Sh. emigrante në Itali, vëllai im D. G. emigrant në Itali dhe motra ime E.B. banuese në Fier të cilët të gjithë bashkë më kanë ndihmuar për të plotësuar shumën e nevojshme për blerjen e apartamentit [...] D.G., ndihma e tij ka qenë në shumën 4,000 euro”.*

²¹ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 2.6.2011.

²² Shkresa e shoqërisë “****” sh.p.k., datë 23.6.2020.

²³ Kontratë shitblerjeje me rezervë nr. ***, datë 22.4.2011.

²⁴ BKT me nr. *** prot., datë 5.6.2020.

7.11 E pyetur nga Komisioni²⁵, që të shpjegojë deklaratimet kontradiktore dhe mospërputhjet në lidhje me përdorimin (destinacionin) e ndihmës familjare, pasi në ILDKPKI ka deklaruar ndihmë familjare në vlerat 8,000 euro dhe 200,000 lekë (dhe po në këtë procesverbal ka deklaruar ndihmë familjare në shumën 1,600,000 lekë), e cila ka shërbyer si burim për të bërë pagesën e datës 8.6.2011 për shoqërinë “***” sh.p.k., në shumën 2,500,000 lekë, ndërsa në pyetësorë ka deklaruar ndihma familjare në vlerat 8,000 euro dhe 250,000 lekë, e cila ka shërbyer si burim për pagesën e vlerës 23,000 euro (depozituar në llogarinë bankare të shoqërisë “***” sh.p.k., në datën 22.6.2011), subjekti ka shpjeguar se: *“Në lidhje me deklaratimet kontradiktore të dhëna prej meje në lidhje me ndihmën ekonomike të dhënë prej familjarëve të mi në vitin 2011, vit në të cilin edhe janë kthyer prej meje... është fakt që familjarët e mi më kanë ndihmuar ekonomikisht duke më dhënë një sasi të hollash në shumën 8,000 euro dhe 250,000 lekë, me qëllim që unë të bëja shlyerjen e një pjese të këstit, për blerjen e apartamentit... në kthimin e përgjigjes para inspektorit i jam referuar fakteve që i referohen kujtesës në kohë, kurse gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, në pyetësorët e plotësuar për të dhënë përgjigje të sakta, jam bazuar në dokumentacionin ligjor të grumbulluar në institucionet përkatëse. Konkretisht: Më datë 22.6.2011, ka kaluar në favor të shoqërisë ‘***’ sh.p.k., shuma prej 23,000 euro dhe si burim krijimi i kësaj vlere ka shërbyer ndihma e dhënë prej familjarëve të mi, 8,000 euro dhe 250,000 lekë, pakësimi i gjendjes cash të deklaruar, si dhe kursimet nga pagat tona deri në muajin qershor 2011”*.

Ndërkohë, në lidhje me burimin e pakësimit të gjendjes cash në vlerën 2,494,000 lekë të deklaruar në deklaratën e pasurisë të vitit 2011, shumë e cila ka shërbyer për pagesën e datës 8.6.2011 për shoqërinë “***” sh.p.k., në shumën 2,500,000 lekë, subjekti shpjegon se: *“[...] ajo është gjendja e depozitës së tërhequr në vitin 2010 në ‘Tirana Bank’ prej bashkëshortit (1,794,700 lekë në datë 3.3.2010) dhe mbyllja e llogarisë së saj bankare të pagës në ‘Raiffeisen Bank’ në vitin 2010 (433.000 lekë në datën 11.1.2010). Sikurse është shpjeguar edhe në pyetësorin nr. 2, mosdeklarimi i tërheqjes së depozitave është (harresë-pakujdesi)”*.

Në lidhje me mospërputhjen e vlerës së ndihmës financiare, subjekti shpjegon: *“Për sa i përket shpjegimeve të dhëna pranë Inspektorit të ILDKPI-së, sqaroj se bëhet fjalë për të njëjtën shumë monetare (paraje) të dhënë si ndihmë prej familjarëve të mi në vitin 2011, shuma prej 8,000 euro dhe 250,000 lekë, shumë e cila gabimisht është shënuar 200,000 lekë. Vlera prej 1,600,000 lekësh është përshkruar si vlerë që rrjedh nga konvertimi i shumës së dhënë në valutë, (euro), në monedhën lekë, shumëzimi i bërë prej mbajtësit të procesverbalit i shumës prej 8,000 euro me kursin ditor të valutës në euro dhe duke e mbledhur atë me shumën 250,000 lekë”*.

7.12 Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “***” sh.p.k. dhe administratorin dhe ortakun e saj, z. P.B., duke kryer korrespondencë me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nga hetimi²⁶ nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

7.13 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ kryesisht, ka konstatuar se:

a) Ka deklarime kontradiktore të palëve²⁷ në lidhje me kohën e kryerjes së pagesave për apartamentin: (i) në deklaratën e datës 2.06.2011 deklarohet se pagesa do të bëhet brenda datës 30.6.2011; (ii) në deklaratën e datës 29.6.2011 deklarohet që palët u likuiduan totalisht midis tyre; (iii) në deklaratën noteriale të datës 24.4.2020 deklarohet që pagesat janë bërë në qershor dhe

²⁵ Shihni pyetësorin nr. 3 në dosje.

²⁶ Prokuroria e Rrethit Tiranë me nr. *** prot., datë 2.6.2020.

²⁷ Subjektit të rivlerësimit bashkë me personin e lidhur/bashkëshortit dhe shoqërisë “***” sh.p.k.

dhjetor të vitit 2011; (iv) në pyetësin nr. 2, subjekti deklaron që pagesat janë bërë në qershor dhe tetor të vitit 2011.

b) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 dhe as në deklaratën *Vetting* shumën 23,000 euro, të paguar në llogari të shoqërisë “***” sh.p.k., si burim për blerje apartamenti.

c) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 dhe as në deklaratën *Vetting* ndihmën financiare të dhënë nga familjarët, si burim krijimi për blerjen e apartamentit. Duke qenë se ndihma familjare është e paprovuar dhe mbetet me karakter deklarativ, nuk është marrë në konsideratë në analizën financiare.

ç) Ka mospërputhje deklarimi në lidhje me shumën e ndihmës financiare, pasi sumat prej 8,000 euro dhe 250,000 lekë nuk janë ekuivalente me vlerën 1,600,000 lekë të deklaruar në ILDKPKI.

d) Ka mospërputhje deklarimi në lidhje me përdorimin e ndihmës financiare: (i) në procesverbalin e ILDKPKI-së, subjekti e deklaron “ndihmën financiare” si burim për “pakësimin *cash* në shumën 2,494,000 lekë” me të cilën është bërë pagesa në shumën 2,500,000 lekë, në datën 8.6.2011, për shoqërinë “***” sh.p.k. ; (ii) në pyetësin nr. 2, subjekti e deklaron “ndihmën financiare” si burim për pagesën e shumës 23,000 euro, në datën 22.6.2011.

dh) Ka mospërputhje të vlerës së apartamentit me 464,845 lekë: (i) subjekti i rivlerësimit, në deklaratën periodike të vitit 2011 dhe në deklaratën *Vetting*, deklaron shumën 87,750 euro (konvertuar në lekë 11,485,285 lekë); (ii) vlera e shumatores së pagesave të deklaruara në pyetësorë nga subjekti është në shumën 11,950,130 lekë.

e) Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme në lidhje me pagesën e shumës 2,500,000 lekë, në datën 8.6.2011 (me burim pakësimin e gjendjes *cash* në vitin 2010), pasi gjendja *cash*, e deklaruar në DPV-në e vitit 2010, në shumën 950,000 lekë, është e pamjaftueshme. Tërheqjet bankare në sumat 433,000 lekë (më 11.1.2010) dhe 1,794,700 lekë (më 3.3.2010) të deklaruara nga subjekti në pyetësorë, si burim për gjendjen *cash* në vitin 2010, nuk janë deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2010.

ë) Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme në lidhje me pagesën e shumës 23,000 euro (3,250,130 lekë) në datën 22.6.2011, pasi një nga burimet e krijimit të kësaj pagesë, që është gjendja *cash* e deklaruar në DPPI-në e vitit 2010 (950,000 lekë), është përdorur për pagesën e datës 8.6.2011. Gjithashtu, edhe dhënia e ndihmës financiare nga të afërmit, e cila nuk është deklaruar në DPPI-në e vitit 2011 dhe në deklaratën *Vetting*, nuk është e provuar me dokumentacion ligjor dhe mbetet vetëm në kuadër deklarativ.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit të rivlerësimit, iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet shoqëruar me provat shkresore, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

7.14 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe në seancën dëgjimore, ka shpjeguar se:

7.14.1 Pasaktësitë minimale për kohën e kryerjes së pagesave apo mospërputhja ekzakte e deklarimeve të bëra nga subjekti gjatë deklarimeve periodike apo gjatë hetimit administrativ, në raport me deklarimet e bëra nga shoqëria “***” sh.p.k., nuk mund të shërbejnë si *indicie* për Komisionin për kualifikim si deklarim i pasaktë i pasurisë. Vlera e plotë e apartamentit është shlyer nëpërmjet 4 (katër) transaksioneve bankare. Asnjë deklaratë e subjektit apo e shoqërisë “***”

sh.p.k., nuk mund të ndryshojnë as datën e pagesës dhe as vlerën e paguar në secilën prej këtyre datave.

Pasaktësitë në deklaratat noteriale apo deklarimet e sipërcituara kanë ndodhur për shkaqe objektive apo për shkak se faktet janë deklaruar referuar kujtesës. Për shkak të kohës së gjatë të kaluar nuk ka qenë e mundur që deklarimet të ishin me saktësi të plotë.

Në deklaratën noteriale nr. ***, datë 2.6.2011, me deklarues shtetasit B.F.Z., Marjeta M. Zaimi dhe P.B. (në të cilën është deklaruar se pagesa do të bëhej brenda datës 30.6.2011), është ndryshuar afati i pagesës përfundimtare që ishte përcaktuar në kontratën e shitblerjes me rezervë. Për arsye objektive edhe ky afat i përcaktuar në këtë deklaratë noteriale nuk është respektuar.

Deklarata noteriale nr. *** rep., datës 29.6.2011 (në të cilën është deklaruar se palët janë likuiduar totalisht dhe nuk kanë detyrime dhe pretendime ndaj njëri-tjetrit), është kryer me qëllim regjistrimin e apartamentit në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshëm (me qëllim që edhe të respektonim afatin e regjistrimit). Kjo deklaratë është nënshkruar në kushtet e mirëbesimit dhe të sigurisë që kishte shitësi për shlyerjen e vlerës, shoqëria “****” sh.p.k., të garantuara këto nga depozitat e subjektit, të cilat do të maturoheshin pas datës 30.6.2011.

Në deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.4.2020, administratori i shoqërisë “****” sh.p.k., z. P.B., ka deklaruar se është likuiduar plotësisht vlera e apartamentit të blerë, likuidim i cili është bërë në periudhën qershor 2011– dhjetor 2011. Në momentin e përpilimit të deklaratës noteriale, palët nuk kanë pasur në dispozicion dokumentacionin e plotë, për shkak të rregullave të vendosura në gjendjen e jashtëzakonshme të krijuar, si rezultat i pandemisë.

7.14.2 Për mosdeklarimin në deklaratën e pasurisë së vitit 2011 dhe në deklaratën *Vetting* të shumës 23,000 euro të paguar në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., si burim për blerje apartamenti, subjekti ka shpjeguar se në DIPP-në e vitit 2011 ashtu edhe në deklaratën *Vetting* është deklaruar shlyerja e plotë e vlerës së apartamentit gjatë vitit 2011. Vlera 23,000 euro është një pjesë e vlerës së çmimit të apartamentit. Në DIPP-në e vitit 2011, nuk është deklaruar se si është kryer shlyerja e çmimit të apartamentit, por cilat pasuri janë pakësuar gjatë këtij viti të cilat kanë shërbyer përfundimisht (drejtpërsëdrejti apo indirekt) për shlyerjen e çmimit të apartamentit. Mospasqyrimi i kësaj rrethane ka qenë pakujdesi/harresë dhe nuk ka pasur për qëllim fshehjen e këtij veprimi.

7.14.3 Për mosdeklarimin në DIPP-në e vitit 2011 dhe në deklaratën *Vetting* të ndihmës financiare të dhënë nga familjarët si burim krijimi për blerjen e apartamentit, subjekti ka shpjeguar se duke qenë se veprimet juridike, dhënia e ndihmës prej familjarëve dhe shlyerja e saj, janë kryer dhe përfunduar brenda vitit 2011, ndihma nuk është paraqitur në DIPP-në e vitit 2011 dhe as në deklaratën *Vetting*. Subjekti shpjegon se ndihma financiare është deklaruar në datën 18.4.2016 në ILDKPKI, pavarësisht gabimit në përshkrimin e destinacionit të saj.

7.14.4 Për mospërputhjen e deklarimit në përdorimin e ndihmës financiare, subjekti ka shpjeguar se deklarimi i kryer në ILDKPKI, në lidhje me destinacionin e përdorimit të ndihmës financiare, është një gabim gjatë mbajtjes së procesverbalit, pasi përgjigjet janë dhënë pa u konsultuar me dokumentet e nevojshme, por vetëm duke iu referuar kujtesës. Gjithashtu, subjekti shpjegon se dhënia e ndihmës financiare nga familjarët është fakt i deklaruar në ILDKPKI. Ndihma financiare ishte e nevojshme për shlyerjen e kështit me qëllim respektimin e afatit kohor të përcaktuar në aktet e bëra prej institucioneve pranë të cilëve kishte aplikuar për t`u trajtuar me kredi.

7.14.5 Lidhur me mospërputhjen e vlerës së apartamentit me 464,845 lekë, subjekti ka shpjeguar se vlera e deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2011 dhe në deklaratën *Vetting* në shumën

11,485,285 lekë nuk është vlera e apartamentit. Vlera e apartamentit është vlera e treguar në kontratën e shitblerjes me rezervë në shumën 87,750 euro. Vlera prej 11,485,285 lekësh tregon pjesën kryesore të burimit të krijimit dhe si burim krijimi për diferencën prej 464,845 lekësh ka shërbyer gjendja *cash* nga viti 2010, si dhe kursimet nga të ardhurat e realizuara në 6-mujorin e parë të vitit 2011, duke përfshirë edhe ndihmën e dhënë prej familjarëve. Subjekti pretendon se vlera e deklaruar e apartamentit në shumën 87,750 euro përputhet plotësisht me vlerën e paguar nëpërmjet transaksioneve bankare.

7.14.6 Për mungesën e burimeve të ligjshme në lidhje me pagesën e shumës 2,500,000 lekë në datën 8.6.2011 (me burim pakësimin e gjendjes *cash* në vitin 2010), subjekti ka shpjeguar se në DIPP-në e vitit 2010 në rubrikën “*të ardhura dhe angazhimet në veprimtari private ose publike*”, ka deklaruar se ka realizuar të ardhura *cash* në shumën 950.000 lekë, që kanë si burim krijimi: kursime nga paga dhe të ardhurat e tjera të deklaruara në atë vit. Pra, subjekti pretendon se vlera 950,000 lekë është shtesë e gjendjes *cash* me të ardhurat e vitit 2010.

Subjekti shpjegon se nga leximi i DIPP-së së vitit 2010 rezulton se gjendja *cash* është në vlerën 3,450,000 lekë, duke rezultuar nga 3,500,000 lekë gjendja nga viti 2009, shtuar me 950,000 lekë kursime të vitit 2010 dhe pakësuar me 1,000,000 lekë nga hapja e depozitës në BKT në vitin 2010.

Subjekti, për të argumentuar se gjendja *cash* në vitin 2010 nuk mund të jetë në vlerën 950,000 lekë, shpjegon se kjo shumë duhej të ishte e barabartë me shumatoren e kursimit të krijuar nga pagat e vitit 2010 + pagesat e tërhequra nga “Raiffeisen Bank” në shumën 433.000 lekë (datë 11.1.2010), si dhe “Tirana Bank” në shumën 1.794.700 lekë (datë 3.3.2010).

Subjekti shpjegon se depozitat e tërhequra nga “Tirana Bank” nuk janë deklaruar në DIPP-në e vitit 2011, por ky gabim është korrigjuar në shënimin e vitit 2011 (bashkëngjitur DIPP-së së vitit 2011).

7.14.7 Për mungesën e burimeve të ligjshme, në lidhje me pagesën e shumës 23,000 euro (3,250,130 lekë) në datën 22.6.2011, subjekti ka shpjeguar se si burim krijimi i kësaj shume kanë shërbyer: ndihma e dhënë prej familjarëve në shumën 8,000 euro dhe 250,000 lekë, pakësimi i gjendjes *cash* të deklaruar, si dhe kursimet nga pagat deri në qershor të vitit 2011. Bazuar edhe në shpjegimin e sipërcituar, pas pagesës së shumës 2,500,000 lekë, vlera e gjendjes *cash* nga viti 2010 ka ngelur afërsisht në 950.000 lekë (diferenca ndërmjet 3.450.000 lekë e gjendjes *cash* në vitin 2010 dhe pakësimit të saj me pagesën e kësaj në shumën 2.500.000 lekë).

Subjekti ka shpjeguar se arsyeja e marrjes së ndihmës nga familjarët ka pasur si qëllim vetëm mos prishjen e kontratave të depozitave dhe humbjen e interesave që do të maturoheshin me mbarimin e afatit të kontratës së depozitës.

Gjithashtu, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacion ligjor në formën e kërkuar nga ligji, me të cilin provohet fakti se të afërmit e subjektit, konkretisht, vëllai G.D. (kontributi 4,000 euro) jeton në Itali dhe punon me dokumente të rregullta që nga viti 2002, vëllai i bashkëshortit S.Z. (kontributi 2,000 euro) jeton në Greqi dhe punon me dokumente të rregullta që nga viti 2000, motra e bashkëshortit A.Sh. (kontributi 2,000 euro) së bashku me bashkëshortin jeton dhe punon në Itali që nga viti 2001, si dhe motra e subjektit E.B. jeton dhe punon në Shqipëri (kontributi 250,000 lekë).

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

7.15 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime bindëse për mospërputhjet e konstatuara në lidhje me deklaratimet për kohën e kryerjes së pagesave të apartamentit.

Deklarata noteriale e datës 2.6.2011 është bërë për të shtyrë afatin e likuidimit, pasi ashtu si vërtetohet edhe nga dokumentacioni nuk rezulton që gjatë kësaj periudhe të jenë bërë likuidime. Deklarata noteriale e datës 29.6.2011 është bërë për efekt regjistrimi të apartamentit në ASHK. Ky fakt vërtetohet edhe nga ASHK-ja, ku me dokumentacionin e përcjellë është vënë në dispozicion edhe kjo deklaratë noteriale së bashku me kontratën e shitjes. Deklarata e datës 24.4.2020 ka pasur si qëllim që të theksojë se vlera e apartamentit është shlyer e plotë brenda vitit 2011 duke filluar nga muaji qershor dhe se deklarimi është i mbështetur në dokumentacion.

Lidhur me shumën 23,000 euro, Komisioni vlerëson se kjo shumë nuk është një pasuri e veçuar e subjektit, e paguar si pagesë shtesë mbi çmimin e apartamentit prej 87,750 euro, por është pjesë përbërëse e çmimit prej 87,750 euro.

Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me mosdeklarimin e ndihmës familjare. Duke qenë se veprimet juridike, dhënia e ndihmës prej familjarëve dhe shlyerja e saj nëpërmjet tërheqjes së depozitave bankare, janë kryer dhe përfunduar po brenda vitit 2011, pra, brenda së njëjtës periudhë deklarimi dhe nuk kanë kaluar në vitin pasardhës si detyrim i pashlyer, nuk ishte detyrim për deklarim në deklaratën periodike të vitit 2011 dhe aq më tepër në deklaratën *Vetting*.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 dhe në deklaratën *Vetting* tërheqjet e depozitave bankare si burime financiare për blerjen e apartamentit, të cilat kanë shërbyer, pikërisht, për shlyerjen e ndihmave familjare, po brenda vitit 2011, ndihma këto që janë përdorur për pagesën e apartamentit me qëllimin për të mos prishur interesat e depozitave, të cilat në qëllimin e tyre final kanë shkuar për pagesën e apartamentit dhe janë deklaruar si të tilla nga subjekti, si në DIPP-në e vitit 2011, ashtu edhe në deklaratën *Vetting*.

Subjekti ka provuar me dokumentacion ligjor se familjarët e tij janë rezidentë të përhershëm dhe kanë marrëdhënie të vazhdueshme dhe të pandërprerë punësimi në Itali dhe Greqi, që në fillim të viteve 2000.²⁸ Shumat e kontribuara prej tyre janë në vlera relativisht të vogla 2,000 - 4,000 euro. Depozitat bankare në emër të subjektit, të tërhequra në vitin 2011, janë të mjaftueshme për të shlyer këto ndihma.

Në lidhje me diferencën e ndihmës familjare, subjekti gjatë hetimit ka shpjeguar se diferenca vjen nga konvertimi. Komisioni vlerëson se pavarësisht diferencave që mund të vijnë nga konvertimi, diferencat nuk janë në vlerën që mund të justifikojnë mospërputhjen e ndihmës familjare në shumën 219,520 lekë²⁹. Komisioni vlerëson se ato mbeten në kuadër të një deklarimi të pasaktë të shumës nga subjekti i rivlerësimit.

Në lidhje mospërputhjen e destinacionit të përdorimit të ndihmës familjare, subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme duke pranuar se kjo mospërputhje ka ardhur për shkak se në deklarim i është referuar kujtesës dhe jo dokumentacionit.

²⁸ Certifikatë vendbanimi e z. D.G. që jeton në shtetin italian nga 2002 e në vijim; dokumentacion i ISSH-së Itali, që vërteton pagimin e sigurimeve nga viti 2002 e në vijim; vërtetim punësimi në shoqërinë “***” nga viti 2002 e në vijim; dokumentacion i ISSH-së Greqi që vërteton pagimin e sigurimeve nga z. S.Z. nga viti 2010 e në vijim; lejeqëndrimi e datës 30.7.2010 e rinovuar periodikisht me vlefshmëri deri më 16.9.2024; certifikatë vendbanimi e znj. A.Sh. që jeton në shtetin Italian nga 2001 e në vijim; lejeqëndrimi të znj. A.Sh. dhe bashkëshortit të saj nga viti 1999; vërtetim i Agjencisë së Tatimeve, Itali për pagesën e detyrimeve ndaj shtetit për znj. A.Sh. dhe bashkëshortin për vitin 2019; vërtetim i ISSH Fier për znj. E.B. (G.) që vërteton pagesën e kontributeve si e vetëpunësuar; vërtetim i ISSH-së Fier për z. L.B. që vërteton punësimin për periudhën 1994 – 2012.

²⁹ Diferenca e ndihmës familjare 1,600,000 – (8,000 euro ose e konvertuar me kursin 141.31 në vlerën 1,130,480 lekë + 250,000) = 219,520 lekë.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit pavarësisht mungesës së dokumentacionit provues të dhënies së ndihmës familjare për shkak të marrëdhënies së posaçme të tij me dhënësit e saj, ka dhënë shpjegime të plota se kjo ndihmë familjare ka shërbyer si burim për pagesën e shumës 23,000 euro.

Në lidhje me mospërputhjen e vlerës së apartamentit, Komisioni, pasi analizoi pagesat e bëra në rrugë bankare, konkludoi se shuma totale e apartamentit është në vlerën 11,950,130 lekë, duke evidentuar kështu pasaktësinë në deklaram nga subjekti i rivlerësimit, si në shumën 87,750 euro, ashtu edhe në shumën 11,485,285 lekë. Edhe subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, konfirmoi se pagesat e kryera për apartamentin janë në vlerën 11,950,130 lekë.

Lidhur me *mungesën e burimeve të ligjshme për pagesën e shumës 2,500,000 lekë* me burim kursimet *cash*, Komisioni vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime bindëse për gjendjen *cash* të vitit 2010. Subjekti ka deklaruar gjatë fazës së hetimit dhe në prapësime se në vitin 2010 ka hapur depozita bankare dhe ka paguar automjetin me burim kursimet *cash* të akumuluar deri në vitin 2009, në shumën 3,500,000 lekë, ka shtuar kursimet me 950,000 lekë për vitin 2010 me të ardhurat nga pagat e vitit, si dhe me tërheqjet bankare nga “Raiffeisen Bank” në shumën 433,000 lekë, datë 11.1.2010 dhe nga “Tirana Bank” në shumën 1,794,700 lekë, datë 3.3.2010. Subjekti ka vënë në dispozicion dokumentin “shënime shtesë” të depozituar në ILDKPKI, për saktësimin e deklaramit në DIPP-në e vitit 2011³⁰. Në këtë shënim shpjegohet se depozitat e tërhequra në vitin 2010, të padeklaruara nga subjekti në DIPP-në e vitit 2010, janë përdorur në vitin 2011 për pagesën e apartamentit. Ky qëndrim i subjektit përforcohet edhe me deklaramin në DIPP-në e vitit 2011, ku subjekti deklaron si burim për pagesën e apartamentit kursimet *cash* të krijuara edhe nga tërheqja e këtyre depozitave, duke krijuar bindjen për Komisionin se gjendja *cash* e pretenduar nga subjekti ka ekzistuar në kohën e krijimit të pasurisë dhe nuk është një pretendim rishtazi i tij, për efekt të procesit të rivlerësimit, pavarësisht pasaktësive të konstatuara.

Në vijimësi të shpjegimeve të mësipërme lidhur me gjendjen *cash* të vitit 2010, Komisioni vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti, në lidhje me burimin e ligjshëm të pagesës prej 23,000 eurosh, qëndrojnë. Gjendja e kursimeve *cash*, më 31.12.2010, në shumën 3,450,000 lekë, është përdorur për pagesën e datës 8.6.2011, në shumën 2,500,000 lekë dhe pjesa e mbetur prej 950,000 lekësh është përdorur për pagesën 23,000 euro të datës 22.6.2011.

Pas analizës së rishikuar të Komisionit rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 199,073 lekë, për pagesën në shumën 23,000 euro, pasi shumatorja e burimeve prej 3,051,057 lekë (950,000 lekë *cash* 2010 + 1,130,480 lekë (8,000 euro x 141.31) + 250,000 lekë ndihma financiare + 720,577 lekë kursime nga pagat deri në qershor 2011) është më e vogël se kundërvlehtë prej 3,250,130 lekësh e pagesës prej 23,000 euro.

7.16 Analizë e burimeve të krijimit të apartamentit me sip.103 m²

7.16.1 Burimi 1: kredi në BKT në shumën 5,000,000 lekë

BKT-ja³¹ konfirmon marrëdhënien e kredisë me subjektin e rivlerësimit sipas kontratës së kredisë bankare³² lidhur në datën 2.6.2011, për shumën 5,000,000 lekë (analizuar gjerësisht në pikën 6 të relacionit).

³⁰ Për shpjegimin e destinacionit të tërheqjes së depozitave.

³¹ BKT-ja me nr. *** prot., datë 27.5.2020 dhe me e-mail-in e datës 29.5.2020.

³² Kontratë e kredisë bankare nr. ***, në BKT.

7.16.2 Burimi 2: pakësuar pasuria e luajtshme, tërhequr depozitat në “Raiffeisen Bank” në vlerën prej 2,498,714 lekësh (tërhequr nga llogaria e Marjeta dhe B.Z.), në “Intesa Sanpaolo Bank” në vlerën 646,749 lekë, si dhe në “Credins Bank” në vlerën 845,882 lekë.

i) Depozita e subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”, në shumën 2,041,085 lekë

“Raiffeisen Bank” konfirmon nëpërmjet “nxjerrjes së llogarisë bankare” me nr. *** në emër të subjektit Marjeta Zaimi në datën 20.10.2011 tërheqjen *cash* të shumës 500,000 lekë, si dhe transferimin e shumës 1,200,000 lekë në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., për pagesë kësti për blerje shtëpie.

Në datën 17.11.2011, subjekti ka tërhequr nga kjo llogari edhe shumën e mbetur prej 341,000 lekësh. Shumat e tërhequra nga llogaria e subjektit Marjeta Zaimi (500,000 lekë; 1,200,000 lekë dhe 341,000 lekë) kanë si burim krijimi kursimet nga pagat, ndër vite, si dhe të ardhurat nga interesat.

ii) Depozita e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit/bashkëshorti B.Z., në “Raiffeisen Bank”, në shumën 495,000 lekë

“Raiffeisen Bank” konfirmon nëpërmjet “nxjerrjes së llogarisë bankare” me nr. *** në emër të bashkëshortit të subjektit tërheqjen *cash* të shumës 495,000 lekë, datë 13.12.2011.

Shuma 495,000 lekë, e tërhequr në datën 13.12.2011, ka si burim depozitën e krijuar në “Raiffeisen Bank” më 25.10.2010, në shumën 1,000,000 lekë, nga bashkëshorti i subjektit, depozitë kjo e deklaruar edhe në deklaratën periodike të vitit 2010. Subjekti ka deklaruar si burim krijimi *një pjesë të depozitës së tërhequr në vitin 2009 dhe të deklaruar në deklarinimin e vitit 2010.*

Në total depozitat e tërhequra në “Raiffeisen Bank” nga llogaritë e subjektit dhe bashkëshortit janë në shumën 2,536,000 lekë (1,200,000 transferuar për llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., dhe 1,336,000 lekë tërhequr *cash* nga subjekti dhe bashkëshorti), nga të cilat subjekti deklaron se ka përdorur si burim për blerjen e apartamentit shumën prej 2,498,714 lekësh.

iii) “Intesa Sanpaolo Bank” konfirmon nëpërmjet “nxjerrjes së llogarisë bankare” me nr. *** në emër të bashkëshortit të subjektit, tërheqjen *cash* të shumës 646,749 lekë në datën 1.12.2011. Kjo depozitë është krijuar nga depozitimi *cash* i shumës 600,000 lekë, në datën 20.1.2010.

Komisioni, me pyetësin nr. 2, ka kërkuar nga subjekti të japë shpjegime në lidhje me burimin e krijimit dhe destinacionin e përdorimit të depozitës së krijuar nga bashkëshorti në “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 20.1.2010, në shumën 600,000 lekë.

Subjekti, në përgjigjen e dërguar, ka sqaruar se: *“Depozitë e tërhequr më 30.1.2009, nga ‘Raiffeisen Bank’, e çelur në emrin tim, në vlerën 659,500 lekë, prej së cilës për krijimin e depozitës së çelur në ‘Intesa Sanpaolo Bank’ në emër të bashkëshortit tim është përdorur shuma e mbetur prej 600,000 lekë”.*

Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të gjendjes *cash* edhe tërheqjen e depozitës në shumën 659,600 lekë, datë 30.1.2009, në “Raiffeisen Bank”, e cila ka shërbyer më pas, më 20.1.2010, për çeljen e depozitës.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me mosdeklarimin e depozitës në DIPP-në e vitit 2010, e cila ka shpjeguar se: *“Mosdeklarimi i depozitës së krijuar në datën 20.1.2010, në ‘Intesa Sanpaolo Bank’, në emër të bashkëshortit B.Z., është harresë (pasaktësi-pakujdesi), edhe pse si veprim financiar i kryer në këtë bankë është lehtësisht i verifikueshëm. Por kjo harresë është*

rregulluar duke u pasqyruar në DIPP për vitin 2011 (është pasqyruar si burim i të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e vlerës së apartamentit të blerë prej shoqërisë “***” sh.p.k., në deklaratën e pasurisë së procesit të rivlerësimit, Vetting, si edhe në shënimin (s qarimin) që i është bashkëlidhur kësaj deklaratë vjetore, për saktësimin e destinacionit të shumave të depozitave të tërhequra në vitin 2011)”.

iv) **“Credins Bank”** konfirmon, nëpërmjet “nxjerrjes së llogarisë bankare” me nr. *** në emër të personit të lidhur me subjektin, bashkëshortit B.Z., tërheqjen *cash* të shumës 866,645.72 lekë, datë 6.7.2011. Subjekti deklaroi se shumën prej 845,882 lekësh të tërhequr e ka përdorur për blerjen e apartamentit. Shuma 866,645.72 lekë e tërhequr nga depozita në datën 6.7.2011 është krijuar në vitin 2004 me depozitim *cash* të shumës 600,000 lekë datë 28.12.2004, nga bashkëshorti i subjektit. Kjo depozitë është shtuar, ndër vite, me interesat e akumuluar, duke krijuar në datën 6.7.2011, gjendjen prej 866,645.72 lekësh.

Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi për depozitën 600,000 lekë.

Komisioni ka kërkuar nga subjekti të japë shpjegime në lidhje me burimin e krijimit dhe destinacionin e përdorimit të depozitës së krijuar nga bashkëshorti në “Credins Bank”, datë 28.12.2004, në shumën 600,000 lekë, e cila ka sqaruar se: *“Duke qenë se prej bashkëshortit tim ishin krijuar disa depozita në ‘Tirana Bank’ me burim krijimi kursime të akumuluar vit pas viti, me qëllim shpërndarjen e tyre, duke u nisur edhe nga interesat e ndryshme në banka të ndryshme, në datën 28.12.2004, prej tij është tërhequr depozita e çelur në datën 18.12.2002, në shumën 943.320 lekë. Një pjesë të kësaj depozite, shumën prej 600.000 lekë, bashkëshorti po atë ditë, pra, në datën 28.12.2004, e ka depozituar në ‘Credins Bank’. Edhe kjo depozitë është përdorur për të shlyer vlerën e apartamentit të blerë në datën 22.4.2011 dhe ka kaluar në llogari të shoqërisë ‘***’ sh.p.k., në korrik të vitit 2011”.*

Nga shuma totale e depozitave të tërhequra në “Raiffeisen Bank”, “Intesa Sanpaolo Bank” dhe “Credins Bank”, në emër të subjektit dhe personit të lidhur/bashkëshortit prej 3,991,345 lekësh (2,498,714 lekë tërhequr nga “Raiffeisen Bank”; prej 646,749 lekësh tërhequr nga “Intesa Sanpaolo Bank” dhe prej 845,882 lekësh tërhequr nga “Credins Bank”), provohet se vetëm shuma e transferuar nga “Raiffeisen Bank” në vlerën 1,200,000 lekë është përdorur për blerjen e apartamentit.

7.16.3 Burimi 3: pakësimi i gjendjes *cash* në shumën 2,494,000 lekë (gjithsej në shumën 6,485,000 lekë të deklaruar në deklaratimet vjetore të pasurive+interesat bankarë të deklaruar më parë), në këtë shumë janë përfshirë edhe të ardhurat nga shitja e banesës së ndodhur në Fier me kontratën e shitblerjes nr. * , datë 2.6.2009, deklaruar në deklaratimet vjetore të pasurisë.**

7.16.3.1 Subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 pakësimin e gjendjes *cash* me shumën 2,494,000 lekë. Referuar DIPP-së së vitit 2010, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* shumën 950,000 lekë, në datën 31.12.2010.

7.16.3.2 Në lidhje me burimin e krijimit të shumës 2,500,000 lekë, subjekti deklaroi në pyetësin nr. 2 se : *“Lidhur me gjendjen e të ardhurave *cash*, të deklaruar në DIPP-në të vitit 2011 si pakësim në vlerën 2,494,000 lekë (2,500,000) lekë, sqaroj se ajo është gjendja e depozitës së tërhequr në vitin 2010 prej ‘Tirana Bank’ prej bashkëshortit tim dhe mbylljen e llogarisë sime bankare të pagës në ‘Raiffeisen Bank’ në vitin 2010, e cila është (harresë-pakujdesi), por që çmoj*

se ka qenë lehtësisht e verifikueshme pranë bankave, ku janë kryer veprimet financiare), konkretisht:

Në datën 11.1.2010, është mbyllur prej meje llogaria e pagës e çelur në datën 1.4.2005, në 'Raiffeisen Bank', Fier dhe është tërhequr shuma e mbetur në llogari në vlerën 433.000 lekë.

Në datën 3.3.2010, është tërhequr prej bashkëshortit tim, B.Z., depozita e çelur në 'Tirana Bank', në vitin 2008, në vlerën 1,794,700 lekë, me burim krijimi, një pjesë e shumës së përfutur nga shitja e banesës në Fier. Për rrjedhojë, në vitin 2010, duke përfshirë edhe të ardhurat cash në vlerën 950,000 lekë, unë kam pasur gjendje në banesë një shumë më të madhe se 2,500,000 lekë, shumë e cila në datën 13.5.2011 është depozituar në BKT, në depozitën që është krijuar për kredinë”.

7.16.3.3 Subjekti në datën 18.4.2016 është thirrur në ILDKPKI për të dhënë sqarime në lidhje me disa çështje, ndër të cilat, edhe për gjendjen cash të deklaruar ndër vite, ku shpjegon se: “Në vitin 2011 kam deklaruar "pakësuar cash shumën 2,494,000 lekë, kam pasqyruar pakësimet në tërësinë e vet duke llogaritur si gjendjen cash ashtu edhe pakësimet në sistemin bankar. Deklarata 'cash 400,000 lekë' e deklaruar, ka pasur si qëllim të pasqyrojë kursimet e vitit 2011, por kjo shumë ka qenë e llogaritur brenda shumës prej 2,494,000 lekë e cila u pakësua në vitin 2011, pasi ka kaluar për shlyerjen e detyrimit për vlerën e mbetur nga kontrata e shitjes së banesës në Fier. Në këtë mënyrë në datën 31.12.2011 ka qenë zero...”.

Gjithashtu, në të njëjtin procesverbal, subjekti deklaroi se: “[...]dhe vlera prej 2,494,000 lekë e cila ka qenë gjendje cash prej 950,000 lekë dhe afërsisht 1,600,000 lekë ndihma e familjarëve të mi [...] Shumën e marrë prej 1,600,000 lekë nuk e kam pasqyruar si burim veçmas pasi e kam përfshirë vlerë totale në pagesën cash që unë i kam bërë firmës. Këtë shumë e kam deklaruar si burim në momentin kur kam depozituar shumën 2,494,000 lekë në bankë BKT në favor të firmës ndërtuese”.

DPPPP-ja³³ konfirmon veprimin bankar, datë 13.5.2011, derdhjen në llogarinë bankare në BKT nga subjekti Marjeta Zaimi të shumës 2,500,000 lekë me burim “të ardhura nga kursimet”, si dhe transferimin e kësaj shume në datën 8.6.2011, në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., për pagesë kapari për blerje apartamenti.

7.17 Komisioni gjatë hetimit administrativ ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti B.Z.:

- Kanë deklarime kontradiktore në lidhje me destinacionin e tërheqjes së depozitave (burimi nr. 2), pasi në DIPP-në e vitit 2011 dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti deklaroi se depozitat kanë shërbyer si burim për pagesën e apartamentit, ndërsa në pyetësorë subjekti deklaroi se kanë shërbyer në mënyrë indirekte për blerjen e apartamentit, pasi me shumën e tërhequra janë shlyer ndihmat e dhëna prej familjarëve.

- Nuk kanë deklaruar në DIPP-në e vitit 2010 krijimin e depozitës në shumën 600,000 lekë.

- Kanë mospërputhje deklarimi në lidhje me burimin e krijimit të shumës 2,500,000 lekë, pasi në pyetësorin nr. 2, subjekti deklaroi si burim gjendjen cash të vitit 2010 dhe tërheqjet e depozitave në vitin 2011 (433,000 lekë dhe shumën 1,794,700 lekë, ndërsa në procesverbalin e ILDKPKI-së deklaroi si burim për shumën 2,500,000 lekë gjendjen cash të vitit 2010 dhe ndihmën familjare.

³³ DPPPP me nr. *** prot., datë 22.5.2020.

- Nuk kanë pasur gjendje *cash* të mjaftueshme për të kryer pagesën në shumën 2,500,000 lekë, në datë 8.6.2011, pasi gjendja *cash* e deklaruar në DIPP-në e vitit 2010 është në shumën 950,000 lekë.

Në lidhje me konstatimet e mësipërme të dërguara nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar si vijon:

Në lidhje me mospërputhjen e destinacionit të depozitave, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të njëjta si në shpjegimet shpeshë të pyetësorit nr. 2, të cilat janë trajtuar nga Komisioni në pikat 7.8 - 7.11, të vendimit.

Mosdeklarimi i depozitës së krijuar në datën 20.1.2010, në “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të bashkëshortit është harresë dhe se kjo harresë është rregulluar në DIPP-në e vitit 2011, kur është deklaruar tërheqja e kësaj depozite.

Lidhur me mospërputhjen e deklarimit për burimin e krijimit të pagesës prej 2,500,000 lekë, si dhe të mungesës së burimit të ligjshëm të kësaj pagese, subjekti ka dhënë shpjegime në pikën 7.14 të vendimit.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

7.19 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me deklaratimet kontradiktore për destinacionin e shumave të tërhequra nga depozitat.

Nga veprimet bankare rezultojnë se tërheqjet e depozitave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, si burim krijimi për blerjen e apartamentit, janë kryer brenda vitit 2011 dhe pas pagesës së datës 22.6.2011. Këto veprime përputhen me shpjegimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit se tërheqja e tyre ka shërbyer për pagesën e ndihmës familjare, ndihmë kjo e shlyer totalisht brenda vitit 2011. Shumat e tërhequra nga depozitat bankare janë të mjaftueshme për shlyerjen e plotë të ndihmës financiare familjare.

Deklarimi i ndihmës financiare në ILDKPKI përpara plotësimit të deklaratës *Vetting*, i krijon bindjen Komisionit se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit janë të vërteta dhe nuk kanë si qëllim kryerjen e veprimeve për të justifikuar fshehjen e pasurisë.

Për konstatimin e mosdeklarimit të depozitës në shumën 600,000 lekë, Komisioni vlerëson se qëndron shpjegimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit. Kjo depozitë është deklaruar në vitin pasardhës si tërheqje, provuar kjo nëpërmjet DIPP-së së vitit 2011.

Lidhur me mospërputhjen e deklarimit për burimin e krijimit të pagesës prej 2,500,000 lekësh, si dhe të mungesës së burimit të ligjshëm të kësaj pagese, Komisioni vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit janë të plota dhe të analizuar në pikën 7.15 të vendimit.

Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti kanë pasur pasaktësi të justifikuar lidhur me apartamentin me sip. 103 m², ndodhur në S., Tiranë të cilat në një vlerësim tërësor, nuk kanë peshë specifike që mund të çojë në aplikimin e ndonjë mase disiplinore.

Subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 199,073 lekë për pagesën e datës 22.6.2011, në shumën 23,000 euro.

7.19 Në lidhje me apartamentin me sip. 85 m², në Fier, i shitur për çmimin 3,100,000 lekë, sipas kontratës së datës 3.7.2008, shumë që, sipas deklaratimeve të subjektit është përdorur për krijimin e gjendjes *cash* prej 1,500,000 lekësh dhe depozitës së tërhequr në “Tirana

Bank” në shumën prej 1,662,6000 lekësh në vitin 2008, të cilat më pas kanë shërbyer për blerjen e apartamentit me sip. 103 m², në Tiranë.

7.19.1 Në deklaratën përpara fillimit të detyrës të vitit 2003, subjekti ka deklaruar: *“Shtëpi banimi e ndërtuar para vitit 1990, me sip. 85 m², me vlerë 3,000,000 lekë, me pjesë 50% me adresë ***, rruga ***, Fier, me burim sipas ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, ‘Për privatizimin e banesave shtetërore’”*. Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti deklaron: *“Shitje paraprake e apartamentit me sip. 85.1 m² me kontratën nr. ***, në shumën 3,100,000 lekë”*.

Gjithashtu, në faqen *** të DIPP-së së vitit 2008, subjekti deklaron: *“Depozitë në ‘Tirana Bank’, me datë 4.7.2008, e krijuar me një pjesë të kontratës së shitjes paraprake nr. ***, në vlerën 1,650,000 lekë”*. Ndërsa në faqen 4, subjekti deklaron: *“Të ardhura cash (një pjesë e kontratës paraprake të shitjes së përmendur në f. *** të deklaratës në shumën 1,500,000 lekë”*. Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti deklaron: *“Shitje e pasurisë së paluajtshme apartamenti me sip. 85.1 m², me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 2.6.2009, në shumën 1,999,760 lekë”*.

7.19.2 Subjekti ka depozituar: (i) kontratën e privatizimit të banesës, datë 10.12.1993, lidhur me Ndërmarrjen Komonale Banesa dhe qiramarrësit B.Z. për privatizimin e banesës në rrugën “***”, kati ***, ndërtuar në vitin 1976, në çmimin 18,221 lekë; (ii) kontratën e shitjes, datë 2.6.2009,³⁴ me shitës B. dhe Marjeta Zaimi dhe blerës K.B., për apartamentin me sip. 85.1 m², nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, k. ***I, shk. ***I, ap. ***, ndodhur në lagjen “***”, Fier, me çmimin 1,999,760 lekë (23,499 lek/ m²). Çmimi është likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale.

7.19.3 ASHK-ja Drejtoria Fier³⁵ konfirmon se shtetasit Marjeta dhe B.Z. kanë pasur të regjistruar në pronësi pasurinë e llojit “apartament” me sip. 85.1 m², nr. ***, z. k. ***, e cila është tjetërsuar në emër të shtetasit K.B. Bashkangjitur është dhe kartela e pasurisë që konfirmon tjetërsimin në emër të K.B., blerë me çmimin 1,999,760 lekë.

7.19.3 E pyetur nga Komisioni³⁶, që të shpjegojë mospërputhjen e konstatuar në lidhje me vlerën e apartamentit me sip. 85 m², në Fier, pasi në deklaratën e vitit 2003 është deklaruar vlera 3,000,000 lekë, ndërsa kontrata e privatizimit pasqyron vlerën 18,221 lekë, subjekti ka shpjeguar se: *“Për sa i përket vlerës prej 3.000.000 lekësh, të deklaruar prej meje në deklaratën vjetore të vitit 2003, kjo përfaqëson vlerën e tregut që kemi menduar se ka pasur apartamenti në kohën e deklarimit. Pra, ka qenë keqkuptim i kërkesës së paraqitur në deklaratën e pasurisë (formularin) që na është dhënë për plotësim në vitin 2004, i cili është plotësuar prej meje siç e kam kuptuar, sepse nuk na është dhënë më parë ndonjë udhëzim për mënyrën se si do të plotësohej”*.

Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me mospërputhjen për sa i përket vlerës së blerjes së apartamentit me sip. 85 m² të përfituar nga ligji i privatizimit që në vitin 1993.

7.19.4 Subjekti i rivlerësimit, me pyetësin nr. 1, ka depozituar kontratën paraprake të shitjes, datë 3.7.2008³⁷, me shitës në të ardhmen B. dhe Marjeta Zaimi dhe blerës në të ardhmen K.B. për shitjen e apartamentit me sip. 85.1 m², ndodhur në lagjen “***”, Fier, duke i premtuar në të ardhmen blerësit K.B., kundrejt vlerës 3,100,000 lekë, vlerë e cila do të likuidohet: *“Sot në ditën*

³⁴ Kontratë shitje nr. ***, datë 2.6.2009, për apartamentin me sip. 85.1 m², Fier.

³⁵ ASHK Drejtoria Vendore Fier me shkresën nr. *** prot., datë 21.2.2020; ASHK Drejtoria Fier me shkresën nr. *** prot., datë 19.5.2020.

³⁶ Shihni pyetësin nr. 3.

³⁷ Kontratë paraprake nr. ***, datë 3.7.2008, lidhur me shtetasin K.B.

e lidhjes së kësaj kontrate paraprake (datë 3.7.2008), pala blerëse në të ardhmen i likuidoi palës shitëse, jashtë zyrës noteriale shumë 3,000,000 lekë. Kësti II dhe i fundit prej 100,000 lekë do bëhet kur pala shitëse të ketë përfunduar pranë ZVRPP-së Fier rifreskimin e dokumentit të pronësisë...Me likuidimin e vlerës së plotë...pala shitëse ka detyrimin ligjor të realizojë para noterit kontratën përfundimtare të shitblerjes”.

Referuar procesverbalit të mbajtur në ILDKPKI, datë 18.4.2016, kur subjekti është pyetur se përse nuk korrespondojnë vlerat në kontratën e shitjes me atë paraprake, subjekti ka shpjeguar se: *“Për shkak të reshjeve të shiut në vitin 2008, duke qenë se banesa ndodhej në zonë informale (në bregun e lumit Gjanica) është dëmtuar nga shirat edhe për këtë arsye blerësi pretendoi që ose t’i ulnim vlerën ose të tërhiqen nga blerja. Meqenëse ne kishim ardhur në Tiranë dhe e kishim të domosdoshme blerjen e një banese dhe shitjen e banesës në Fier ramë dakord që ta shisnim me vlerën më të ulët se sa vlera e kontratës paraprake. Pra në këtë rast i kemi kthyer vlerën rreth 1,050,000 lekë me dy këste të ndodhura më pas në vitin 2011-2012”.*

Në të njëjtin procesverbal, subjekti ka deklaruar: *“Në vitin 2010 gjendja cash në banesë ka qenë në shumë 950,000 lekë duke e pakësuar gjendjen cash të vitit 2009. Destinacioni i pakësimit ka qenë hapja e depozitave në ‘Raiffeisen Bank’, në shumë 1,000,000 lekë, në BKT në shumë 1,000,000 lekë, ‘Intesa Sanpaolo Bank’ depozitë 600,000 lekë, si dhe blerje automjeti në shumë 900,000 lekë, duke na mbetur nga gjendja cash e vitit 2009 shuma prej 660,000 lekë me të cilën kemi shlyer një pjesë të kështit për blerësin e banesës sipas marrëveshjes të cilën e kam sqaruar më lart. Në këtë mënyrë gjithë kursimet nga viti 2009 u bënë 0 (zero). Pra, shuma prej 950,000 lekë ka qenë kursime nga të ardhurat e vitit 2010”.*

7.19.5 E pyetur nga Komisioni³⁸, në lidhje me këtë mospërputhje të çmimit, subjekti ka deklaruar se: *“Vlera e apartamentit të shitur në vitin 2009, nuk është mospërputhje, por vlerë e përcaktuar në dy akte të ndryshëm noterialë të bërë në vitin 2008 dhe në vitin 2009 dhe e deklaruar në deklaratat periodike të pasurisë respektivisht në vitet 2008 dhe 2009. Kjo ka ndodhur pasi, në vitin 2008, unë dhe bashkëshorti im i kemi shitur paraprakisht shtetasit K.B., apartamentin që kishim në bashkëpronësi, kundrejt vlerës 3 100 000 lekë. Prej këtij shtetasi në muajin korrik 2008, kemi marrë shumë 3 000 000, pasi pjesa prej 100 000 lekë do të jepej në momentin e rifreskimit të dokumenteve (shihni kontratën e shitjes paraprake). Por, për shkak se në vitin 2008, kanë rënë shumë reshje dhe banesa, e cila ndodhej pranë bregut të lumit Gjanica, Fier, është dëmtuar nga lagështira, prej blerësit u pretendua që ose të blinte banesën në vlerë më të ulët, ose do të tërhiqej nga blerja e saj. Duke qenë se ishim të interesuar që këtë banesë ta shisnim, për shkak se kishim ardhur në qytetin e Tiranës, ku edhe jetonim me qira dhe e kishim të domosdoshme blerjen e një apartamenti, ramë dakord që ta shisnim me vlerë më të ulët se sa vlera e parashikuar në kontratën paraprake të shitjes. Për këtë arsye në kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 2.6.2009, është pasqyruar vlera 1,999,760 lekë, e cila është vlera e shitjes së këtij apartamenti, duke iu referuar çmimit të referencës së zonës ku ndodhej ai, duke kthyer diferencën e vlerës së dhënë në vitin 2008, blerësit.*

Sqarim: *depozita në ‘Tirana Bank’ e krijuar me një pjesë të kontratës së shitjes paraprake nr. ***, në vlerën 1,650,000 lekë, është çelur në 4.7.2008”.*

7.19.6 Komisioni, gjatë hetimit³⁹, ka kërkuar nga subjekti të shpjegojë: (a) mospërputhjen në deklaram për kthimin e diferencës së vlerës së dhënë në vitin 2008 nga blerësi K.B., pasi në

³⁸ Shihni pyetësin nr. 2.

³⁹ Me pyetësin nr. 3.

procesverbalin e datës 18.4.2016 në ILDKPKI ka deklaruar kthimin e shumës 1,050,000 lekë me dy këste në vitet 2011-2012 dhe, po në të njëjtin procesverbal, ka deklaruar një pjesë prej 660,000 lekësh të kthyer në vitin 2010; (b) të përcaktojë saktë datën e kthimit të diferencës blerësit K.B.; (c) të shpjegojë mospërputhjen e shumës 1,050,000 lekë së deklaruar si kthim me diferencën që rrjedh nga çmimet e kontratave në vitet 2008 - 2009 (3,000,000 – 1,999,760 lekë = 1,000,240 lekë); (c) të përcaktojë burimin e kthimit të këtyre shumave.

Subjekti ka shpjeguar se: (a) “[...] në kthimin e përgjigjes para inspektorit i jam referuar faktit që shumën e kemi kthyer në dy këste, por vitet 2011-2012, janë pasqyruar gabim (gabim material), që mund ta kem ngatërruar me periudhën kohore të blerjes së banesës në qytetin e Tiranës dhe akomodimit të saj, që i përket viteve 2011-2012.... Referuar kujtesës, para inspektorit kam përmendur vitin 2009 dhe jo 2010. Gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, për të përgatitur përgjigjet e pyetjeve respektive sipas pyetësorëve të dërguar prej Komisionit, për të dhënë përgjigje të sakta dhe të bazuara mbi dokumente, i jam referuar dokumentacionit ligjor të nevojshëm. Nga këto dokumente, si dhe të dhënave që paraqiten në to, rezulton se diferencën e vlerës së dhënë prej z. K.B. në vitin 2008, unë dhe bashkëshorti im e kemi kthyer në dy këste përgjatë vitit 2009.”; (b) “[...] sqaroj se shuma e diferencës së vlerës së dhënë prej z. K.B. në vitin 2008, në kohën e blerjes paraprake të banesës që ne kishim në pronësi në qytetin e Fierit është dhënë në dy këste, pas bërjes së kontratës së shitjes së banesës. Shuma prej 660,000 lekësh është dhënë në muajin qershor të vitit 2009, data e saktë nuk më kujtohet; Shuma prej 340,240 lekë është dhënë në korrik të vitit 2009, data e saktë nuk më kujtohet.”; (c) “Mospërputhja e shumës së deklaruar prej meje si kthim me diferencën që rrjedh nga kontratat [...] është dukshëm një gabim material. Diferenca e kthyer prej nesh është ajo që është pasqyruar nga diferenca e vlerave të pasqyruara në këto dy akte. Kur kam dhënë shpjegime pranë Inspektorit unë kam pasur parasysh si vlerë të mbetur me përfaqësi 1,000,500 lekë (pasi nuk kam bërë zbritjen në këtë moment të vlerave). Vlera 1,050,000 lekë, mund të jetë lapsus, duke u ndryshuar vendi i numrit “5” gjatë redaktimit të aktit, pasi vlera që duhet të kthenim del qartë nga zbritja e vlerës së pasqyruar sipas kontratës së shitjes paraprake dhe kontratës së shitjes së banesës.”; (d) “[...]si burim për kthimin e shumës 1,000,240 lekë kanë shërbyer gjendja cash e deklaruar në DVP e vitit 2008, nga një pjesë e vlerës së përfituar nga shitja paraprake e banesës (saktësisht shuma prej 1,350,000 lekë)”.

7.19.7 Komisioni ka analizuar dhe çmimin e shitjes së këtij apartamenti, duke e krahasuar me çmimin referues të EKB-së për vitet 2008⁴⁰ dhe 2009, sipas deklarimit të subjektit në deklaratat respektive, ku dhe përcaktohet çmimi i apartamenteve në tregun e lirë për vitet 2008 dhe 2009 (pasi për vitin 2009 janë marrë referencë çmimet e vitit 2008), i cili për qytetin e Fierit, është 55,062 lekë/m². Duke llogaritur 85.1 m² x 55,062 lekë vlera totale do të ishte 4,685,776 lekë, pra, ka diferencë ndërmjet çmimit të shitjes së subjektit me çmimin referues të EKB-së.

7.19.8 Komisioni ka hetuar dhe për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit Marjeta Zaimi me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe shtetasit P.B. dhe K.B. dhe për këtë qëllim ka kërkuar nga Prokuroritë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Fier informacion në lidhje me procedime dhe kallëzime në ngarkim të tyre.

⁴⁰ Udhëzim nr.1, datë 20.8.2008 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2008”.

Komisioni vëren se nuk është konstatuar konflikti i interesit i subjektit Marjeta Zaimi me subjektet e lartpërmendura⁴¹.

7.19.9 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ kryesisht, ka konstatuar se:

- a) ka deklarime kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me vlerën e shitjes së apartamentit me sip. 85 m², në Fier, pasi në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar shitur me vlerën 3,100,000 lekë, ndërsa në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar vlerë shitjeje 1,999,760 lekë;
- b) subjekti i rivlerësimit nuk ka dokumentuar me dokument noterial revokimin e kontratës paraprake të vitit 2008, referuar ndryshimit të çmimit nga 3,100,000 lekë në 1,999,760 lekë në vitin 2009, sipas pretendimit të tij;
- c) subjekti nuk ka deklaruar kthimin e diferencës prej 1,000,240 lekësh në vitin 2009, sipas deklarimit në pyetësorin nr. 3, si dhe nuk ka provuar me dokumentacion ligjor kthimin e saj;
- d) ka diferencë të theksuar të çmimit të shitjes, pasqyruar në kontratën e shitjes, datë 2.6.2009, si dhe në deklarimet e subjektit, krahasuar me çmimet referuese të EKB-së, vlera e vendosur në kontratën e shitjes dhe në deklarimet e subjektit është shumë më e ulët se çmimi referues i EKB-së.

7.19.10 Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, pas kalimit të barrës së provës me rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe në seancën dëgjimore, ka shpjeguar se:

- a) lidhur me deklarimet kontradiktore të çmimit të shitjes, deklarimet e dhëna në DIPP-të për vitet 2008 dhe 2009, tregojnë me vërtetësi faktet, ashtu siç kanë ndodhur dhe këto deklarime u referohen dokumenteve të ndryshme. Ndryshimi i vlerës së apartamentit nga 3,100,000 lekë në kontratën paraprake të shitjes të datës 3.7.2008 (paguar 3,000,000 lekë), në 1,999,760 lekë në kontratën e shitjes së pasurisë të datës 2.6.2009, ka ndodhur për shkak të përmbytjeve të ndodhura në qytetin e Fierit. Në këto kushte, subjekti deklaroi se ndodhej para dy opsioneve: ose të revokonte kontratën e shitjes paraprake, ose të ulte çmimin. Ndodhur në kushtet e nevojës për ta shitur apartamentin dhe të bindur se vlera e apartamentit nuk do të rritej për shkak të dëmtimit nga përmbytjet, subjekti deklaroi se konkluduan në kontratën e shitjes me vlerë 1,999,760 lekë. Kjo vlerë u përcaktua duke pasur parasysh se blerësi do të bënte investime, për ta kthyer objektin në gjendjen e mëparshme, si dhe për të parandaluar dëmtimin e objektit në të ardhmen nga i njëjti fenomen;
- b) lidhur me mungesën e një dokumenti noterial për revokimin e kontratës paraprake të vitit 2008, kjo kontratë, ashtu edhe kontrata përfundimtare e shitjes e vitit 2009, janë deklaruar rregullisht në DIPP-të përkatëse dhe, për këtë arsye, nuk ka pasur qëllim për fshehje transaksioni;
- c) për mosdeklarimin e kthimit të diferencës prej 1,000,240 lekësh në vitin 2009 dhe mungesën e një dokumenti ligjor për të provuar këtë kthim, një provë indirekte për kthimin e shumës 1,000,240 lekë në vitin 2009 është analiza e gjendjes *cash* për vitin 2009. Nëse do të kryenim përlllogaritjet e gjendjes *cash* të vitit 2008, duke shtuar depozitën e tërhequr në “Raiffeisen Bank” në shumën 659.500 lekë, si dhe kursimet e realizuara nga të ardhurat në vitin 2009, rezultati do të ishte më i lartë se gjendja *cash* e deklaruar prej subjektit në shumën 3.500.000 lekë. Për të vërtetuar me dokumentacion ligjor kthimin e shumës prej 1,000,240 lekësh, në mungesë të blerësit, i cili

⁴¹ Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. *** prot., datë 22.4.2020; Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier me nr. *** prot., datë 21.4.2020.

ndodhet jashtë Shqipërisë, subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratën noteriale të nënës së blerësit të datës 17.10.2020.

d) diferenca e theksuar e çmimit të shitjes së apartamentit në Fier, pasqyruar në kontratën e shitjes së datës 2.6.2009, e krahasuar me çmimet referuese të EKB-së, nuk qëndron. Çmimi i referencës së përcaktuar prej EKB-së në shitjen e apartamentit përfaqëson vlerën e shitjes për objekte të ndërtuar në vitin 2008 dhe jo të një objekti të ndërtuar para vitit 1990. Gjithashtu, ky çmim nuk i përgjigjet as zonës ku ndodhej apartamenti.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

7.19.11 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, i konsideroi të mjaftueshme. Lidhur me mospërputhjen e çmimit të shitjes së apartamentit në Fier, subjekti shpjegoi se kjo diferencë erdhi si pasojë e përmbytjeve të ndodhura në qytetin e Fierit, që diktuan dhe ndryshimin e çmimit të kontratës me blerësin. Subjekti depozitoi një dokument të lëshuar nga Prefektura Fier, ku u konfirmua fakti i përmbytjeve në atë periudhë. Gjithashtu edhe nga blerësi (nëpërmjet përfaqësuesit, nënës së tij) me deklaratën noteriale të vitit 2020 u konfirmua ndryshimi i çmimit për shkak të përmbytjeve dhe kthimi i diferencës së shumës. Në lidhje me mosdeklarimin e kthimit të shumës në deklaratën periodike të vitit 2009, Komisioni vlerëson se ky veprim nuk mund të konsiderohet si tentativë e subjektit për fshehje, pasi vetë subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2008, shumën 3,100,000 lekë dhe në DIPP-në e vitit 2009, shumën 1,999,760 lekë. Gjithashtu, referuar analizës financiare për vitin 2009, subjekti dhe bashkëshorti kanë rezultuar me balancë pozitive dhe me mundësi financiare për kthimin e shumës në vitin 2009 si diferencë të çmimit.

Komisioni, pasi mori në analizë shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, arriti në konkluzionin se subjekti shpjegoi bindshëm diferencën në lidhje me vlerat e shitjes së apartamentit, si dhe problematikat e tjera të konstatuara në lidhje me këtë pasuri. Gjithashtu, nga analiza financiare e vitit 2009, subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti rezultojnë me burime të ligjshme financiare, të cilat mundësonin kthimin e diferencës së çmimit (shihni analizën financiare në pikën 9 të vendimit).

8. Autoveturë tip “Mercedes-Benz”, me targa *, blerë me kontratën nr. ***, datë 6.7.2010. Vlera: 4,000 euro. Pjesa takuese: 100%.**

Burimi i krijimit: të ardhurat e grumbulluara nga kursimet nga paga e subjektit dhe bashkëshortit të deklaruara në deklaratimet vjetore të mëparshme.

8.2 Personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti B.Z., në DIPP-në e vitit 2010 ka deklaruar: *“Blerje veture tip Benz me targa ***, datë 6.7.2010, me kontratën nr. ***, në shumën 4,000 euro. Burimi i të ardhurave: kursimet e familjes. Detyrimet doganore së bashku me taksat e ndryshme 374,100 lekë. Pjesa takuese: 100%”.*

8.3 Subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes së automjetit, datë 6.7.2010⁴², me shitës B.K. dhe blerës B.Z. për automjetin “Mercedes-Benz”, viti 2002, tipi “E203, C220”, me targa ***, në shumën 4,000 euro, likuiduar mes tyre.

8.4 E pyetur nga Komisioni⁴³, që të specifikojë saktë cilat janë kursimet e familjes të deklaruara më parë dhe të përdorura si burim krijimi për blerjen e këtij mjeti, subjekti ka shpjeguar se: *“Vlera*

⁴² Kontratë shitblerje automjetit nr. ***, datë 6.7.2010.

⁴³ Shihni pyetësin nr. 2.

*e autoveturës së tipit ‘Mercedes-Benz’ me targa *** (e konvertuar në lekë sipas kursit të kohës), së bashku me pagesën e detyrimit doganor dhe taksave të tjera, është shlyer nga pjesa e të ardhurave të mbetura nga deklarimi i gjendjes cash në vitin 2008, pjesa e të ardhurave të deklaruar cash për vitin 2009, dhe diferenca e mbetur, prej depozitës në ‘Raiffeisen Bank’ në emrin tim, e tërhequr në datën 30.1.2009, të deklaruar më parë dhe të sqaruara edhe në pyetësor”.*

Komisioni vëren se subjekti në DIPP-në e vitit 2009 ka deklaruar kursime *cash* në shumën 3,500,000 lekë, shumë e cila përfshin edhe tërheqjen e depozitës në “Raiffeisen Bank”, në datën 30.1.2009 dhe, për rrjedhojë, subjekti ka pasur burime financiare të mjaftueshme për blerjen e automjetit në datën 6.7.2010, në shumën 920,980 lekë.

8.5 DPSHTRR-ja⁴⁴ ka depozituar dosjen e automjetit me targa ***. Rezulton se automjeti tip “Mercedes-Benz E203” është blerë nga shtetasi B.K. me kontratën e shitjes nga shtetasi Ch.W. në datën 30.6.2010, në shumën 3,000 euro. Mandatpagesa e datës 6.7.2010, në “Tirana Bank” konfirmon pagesën e taksës doganore në shumën 336,000 lekë nga shtetasi B.K.

Me kontratën e datës 6.7.2010⁴⁵, shtetasi B.K. ia shtet shtetasit B.Z. automjetin me çmimin 4,000 euro, praktikisht me humbje, veprim i cili nuk qëndron për nga logjika e shitjes së tregut të makinave.

8.6 Subjekti është pyetur nga Komisioni ⁴⁶ të shpjegojë nëse nga koha e marrjes së detyrës ka pasur ndonjë shpenzim më të lartë se vlera prej 2,500 eurosh, e cila ka shpjeguar se: “[...] në datën 6.7.2010 është blerë automjeti me targa *** në emër të bashkëshortit tim në vlerën 4,000 euro ... gjithashtu, është bërë dhe pagesa e zhdoganimit të këtij mjeti në doganën e Kakavijës së bashku me detyrimet që kanë të bëjnë me regjistrimin e mjetit dhe siguracionin në vlerën 374,100 lekë”. Subjekti ka depozituar konfirmimin bankar të pagesës së detyrimit doganor, datë 5.7.2010, lëshuar nga “Tirana Bank” (dega Kakavijë), kryer nga shtetasi B.K.

8.7 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se ka pasaktësi në deklarim nga subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshortit B.Z. për vlerën e blerjes së automjetit, pasi në deklaratën *Vetting* është deklaruar çmimi i blerjes në shumën 4,000 euro dhe nuk është deklaruar vlera doganore dhe shpenzime të tjera në shumën 374,100 lekë.

Për konstatimin e mësipërm, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, për të dhënë argumentet shoqëruar me provat shkresore, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

8.8 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe në seancën dëgjimore, ka shpjeguar se në deklaratën *Vetting* është deklaruar vlera e automjetit referuar kontratës së shitblerjes, pa përfshirë shpenzimet për zhdoganimin dhe shpenzimeve të tjera në shumën 374.100 lekë. Ky deklarim është kryer në përputhje me kërkesat e parashikuara në formularin e deklaratës *Vetting*, sipas të cilit duhet të përshkruhej çmimi i blerjes.

Subjekti shpjegon se në DIPP-në e vitit 2010 ka deklaruar krahas çmimin e blerjes së automjetit në vlerën 4,000 euro edhe shpenzimet e zhdoganimit dhe të tjera në shumën 374,100 lekë dhe në

⁴⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 24.4.2020, e DPSHTRR-së.

⁴⁵ Kontratë e shitblerjes së automjetit nr. *** , datë 6.7.2010, me shitës B.K. dhe blerës B.Z. për automjetin tip “Mercedes-Benz W203”, me çmimin 4,000 euro.

⁴⁶ Shihni pyetësorin nr. 1.

përfundim kostoja e blerjes së automjetit është në shumën 920,980 lekë, aq sa është marrë në konsideratë nga Komisioni në analizën financiare.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

8.9 Komisioni vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme për konstatimin e Komisionit lidhur me deklarin e vlerës së automjetit. Komisioni analizoi deklaratën *Vetting*, ku në seksionin “deklarimi i pasurive” në udhëzimet për deklarim është e cilësuar, ndër të tjera, që përveç çmimit të blerjes duhen deklaruar dhe shpenzimet e tjera të kryera për pasurinë, ndryshe nga ajo që subjekti deklaroi.

Komisioni, pasi mori në konsideratë shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, arriti në përfundimin se ka bërë deklarim të pasaktë të pasurisë në deklaratën *Vetting*, por duke qenë se ka kryer deklarim të saktë të kësaj pasurie në DIPP-në e vitit 2009, kjo pasaktësi në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur/bashkëshortin, konsiderohet me peshë minimale, që nuk sjell si pasojë aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që mund të çojë deri në aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit nga detyra.

9. Llogari bankare me nr. *, datë 14.8.2015, në shumën 1,500 lekë, në BKT**

BKT-ja⁴⁷ konfirmon llogarinë rrjedhëse në emër të bashkëshortit të subjektit të krijuar në datën 14.8.2015, me depozitim e shumës 1,500 lekë. Gjendja në këtë llogari në datën 31.12.2016 është në shumën 1,000.36 lekë. Në këtë llogari për vitin 2016 ka pasur vetëm një kreditim në shumën 40,000 lekë nga shtetasi M.Gj. me përshkrimin “kaluar 40,000 lekë nga M.Gj. në favor të ekspertit të gjykatës B.Z.”. Në këtë llogari, në vitin 2017 dhe në vijim janë kryer pagesat për ekspertim në gjykatë.

Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me llogarinë bankare në BKT, në emër të bashkëshortit të subjektit.

10. Depozitë, krijuar në datën 25.10.2010, në vlerën 1,000,000 lekë në BKT dhe gjendje në datën 26.1.2017, konvertuar më pas në shumën 8014.53 euro. Pjesa takuese: 50%.

Burimi krijimi: një pjesë e depozitave të tërhequra në vitet 2009 – 2010 dhe kursime nga paga, të deklaruara në deklarin e pasurisë në vitin 2010. Në datën 6.8.2012 kjo depozitë konvertohet në euro në shumën 7,846.10 euro dhe në datën 23.12.2015 kjo depozitë kthehet në dy emra (+interesat ndër vite).

Komisioni e ka trajtuar gjerësisht këtë llogari në pikën 1 të vendimit.

PERSONI I LIDHUR ME SUBJEKTIN/DJALI S.Z.

11. Llogari bankare page në “Credins Bank”, me gjendje në datën 26.1.2017, në shumën 6309 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burim krijimi: të ardhura nga pagat.

“Credins Bank”⁴⁸ konfirmon llogarinë e pagës në emër të djalit të subjektit me gjendje në datën 26.1.2017, në shumën 6,309 lekë.

⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 17.2.2020, e BKT-së.

⁴⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 17.2.2020, e BKT-së.

Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me llogarinë bankare në “Credins Bank” në emër të djalit të subjektit.

KONSTATIME TË TJERA

12. Në lidhje me apartamentin me sip. 62 m², ndodhur në Ç., Skrapar, ku bashkëshorti i subjektit, z. B.Z. është bashkëpronar.

12.1 ASHK-ja Zyra Vendore Skrapar⁴⁹ konfirmon se shtetasi B.F.Z. rezulton bashkëpronar për pasurinë e llojit “apartament” me sip. 62 m² në bashkëpronësi, pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, ndodhur në lagjen “***”, Ç., Skrapar.

Nga dokumentacioni bashkangjitur rezulton se ky apartament është përfituar nga kontrata e privatizimit të banesës, datë 19.7.1993, e lidhur midis Ndërmarrjes Komonale Banesa Ç. dhe shtetasit F.Z., për banesën nr. ***, 2+1, lagjja “***”, e blerë me çmimin 24,469 lekë. Në përbërjen familjare shtetasi F.Z. kishte si pjesëtarë: J. (bashkëshortja), B., A., S. dhe A.Z. (fëmijët).

Vendimi nr. ***, datë 3.4.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Skrapar, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së trashëgimlënësit F.Z., përcakton si trashëgimtarë të tij: J. (bashkëshortja), P., B., A., S. dhe A.Z., të cilët trashëgojnë nga 1/6 secili pjesë të pasurisë trashëgimore.

Me deklaratën noteriale, datë 19.6.2006⁵⁰, shtetasit P.Z. dhe B.Z. kanë deklaruar se *heqin dorë nga çdo pasuri e luajtshme dhe e paluajtshme të trashëguar prej babait tonë, të ndjerit F.Z. dhe janë dakord që pjesët e tyre të pronësisë që trashëgojnë prej tij si të pasurive të luajtshme dhe ato të paluajtshme të kalojnë në emër të nënës së tyre J.Z.*

12.2 Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti nuk kanë deklaruar në deklaratat për vitet 2003 – 2016, si dhe në deklaratën *Vetting* pjesën në bashkëpronësi të bashkëshortit për apartamentin me sip. 62 m², në Ç. dhe me pyetëtorin nr. 2 i ka kërkuar subjektit shpjegime.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Lidhur me faktin se bashkëshorti im, B.Z., është bashkëpronar në apartamentin me sipërfaqe 62 m², i ndodhur në Ç., jam vënë në dijeni nëpërmjet këtij pyetëtori. Nuk kemi pasur dijeni në lidhje me këtë fakt dhe është kjo arsyeja që, prej bashkëshortit tim, nuk është deklaruar në asnjë prej deklaratave periodike vjetore nga viti 2003 deri në vitin 2016, në deklaratën *Vetting*, si dhe në deklaratat vijuese. Për të konfirmuar zyrtarisht këtë fakt, para nisjes së procesit të rivlerësimit, bashkëshorti im i është drejtuar me kërkesë për informacion ZVRPP Skrapar, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 17.1.2019, ka konfirmuar se “Nuk ka pasuri të regjistruara dhe nuk ka kryer asnjë marrëdhënie juridike me ZVRPP Skrapar”. [...] në datën 24.3.1992, jam martuar me bashkëshortin, B.Z. dhe sipas certifikatës familjare që pasqyron përbërjen time familjare në datën 25.3.1992, rezulton se familja jonë pas kësaj date përbëhej nga unë dhe bashkëshorti im, B.Z. Bazuar në këtë gjendje familjare, sipas ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, ‘Për privatizimin e banesave shtetërore’, ne kemi përfituar banesën, apartamentin, në të cilin jetonim dhe që ndodhej në qytetin e Fierit, në bazë të nenit 20 të këtij ligji, i cili parashikon se: ‘Për efekt të zbatimit të këtij ligji, merret për bazë përbërja familjare dhe gjendja e strehimit që rezulton në regjistrat themeltarë të shtetasve në datën 1 dhjetor 1992’. Në dijeninë time, edhe familjarët e bashkëshortit tim, që jetonin në Ç.-Skrapar, mbi bazën e të njëjtit ligj, nr. 652, datë 23.12.1992, ‘Për privatizimin e banesave shtetërore’, kanë përfituar*

⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 11.5.2020, e ASHK-së Zyra Vendore Skrapar.

⁵⁰ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 19.6.2006.

*apartamentin me sipërfaqe 62 m². Pas vdekjes së babait të bashkëshortit tim, të ndjerit F.Z., prej trashëgimtarëve të tij është bërë çelja e dëshmisë së trashëgimisë”. [...] me deklaratën noteriale nr. ***, datë 19.6.2006, bashkëshorti im, B.Z. dhe vëllai i tij, P.Z., kanë hequr dorë vullnetarisht nga çdo pasuri e luajtshme apo e paluajtshme e babait të tyre të ndjerë. Ata kanë rënë dakord që pjesët e tyre të pronësisë që trashëgojnë prej tij, si të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, të kalojnë në emër të nënës së tyre, J.Z.”.*

12.3 Komisioni vëren se ndërkohë që për periudhën 2003 – 2006, subjekti duhej të deklaronte pjesën e bashkëpronësisë për apartamentin më sip. 62 m², në Ç., të përfutur nga privatizimi në vitin 1993, nga informacioni i ZVRPP-së Skrapar nuk ka rezultuar të ketë pasur pasuri në bashkëpronësi. Gjithashtu, nga ZVRPP-ja Skrapar, në momentin e depozitimit të deklaratës noteriale të vitit 2006, duhej të bëhej pasqyrimi i kësaj deklarate në kartelën e pasurisë dhe kjo pasuri mos të figuronte më në bashkëpronësi edhe me B.Z.

Komisioni, pasi mori në konsideratë shpjegimet dhe provat e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, e konsideron një pasaktësi mosdeklarimin e pjesës takuese në deklaratat e pasurisë 2003 – 2006, nga personi i lidhur me subjektin/bashkëshorti B.Z., pasaktësi e cila, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti dhe bashkëshorti kanë kaluar në gjendje të veçantë familjare në vitin 1992, privatizimi i banesës në Ç. është bërë nga babai i bashkëshortit në cilësinë e kryefamiljarit dhe për më tepër në vitin 1993, vlerësohet me peshë të papërfillshme në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit në lidhje me kriterin e pasurisë, që nuk sjell si pasojë aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, që mund të çojë deri në aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit nga detyra.

13. Në lidhje me banesën e shtetasit A.Z. (vëllai i bashkëshortit të subjektit) me vendndodhje rruga “**”, pallatet “****”, Njësia Bashkiake Nr. ***, Tiranë**

13.1 Gjatë hetimit administrativ⁵¹, subjekti ka deklaruar se për periudhën 1.6.2008 – 1.6.2010, ka qëndruar me qira kundrejt pagesës 15,000 lekë/muaj dhe për periudhën 1.6.2010 – 1.10.2011, subjekti ka qëndruar pa qira në banesën e vëllait të bashkëshortit, shtetasit A.Z.

13.2 Komisioni, nisur nga dyshime në lidhje me pronësinë e këtij apartamenti me pyetësin nr. 4, i ka kërkuar subjektit të provojë me dokumentacion pronësinë e kësaj banese në emër të shtetasit A.Z. (kontrata sipërmarrje/shitje, certifikatë pronësie, librezë dritash/uji, si dhe dokumente që vërtetojnë qëndrimin e tij në shtetin grek).

Subjekti, në përgjigje të pyetësit, ka dërguar dokumentacionin (kontrata sipërmarrje/shitje, certifikatë pronësie, librezë uji/dritash)⁵², ku rezulton pronësia e kësaj banese në emër të shtetasit A.Z. Gjithashtu, subjekti ka depozituar dokumentacionin (leje qëndrimi) që vërteton faktin se shtetasi A.Z. është rezident në shtetin grek.

13.3 Gjithashtu, Komisioni ka kërkuar informacion nga UKT-ja dhe FSHU-ja në lidhje me kontratat përkatëse për këtë apartament.

⁵¹ Në pyetësin nr. 2.

⁵² Kontratë sipërmarrjeje, datë 24.2.2004, lidhur ndërmjet sipërmarrësit shoqërisë “****” sh.p.k. dhe porositësit A.Z. për apartamentin me sip.120 m², me adresë rruga “****”, Tiranë; kontratë shitblerjeje, datë 20.6.2008, me shitës shoqërinë “****” sh.p.k. dhe blerës A.Z. dhe E.Z. për apartamentin me sip.120 m² me adresë rruga “****”, Tiranë, me çmim 35,200 euro; certifikatë pronësie, datë 21.8.2015, në emër të A.+E.Z. për ap.110,09 m² me adresë rruga “****”, librezë uji në emër të A. Z., librezë dritash në emër të A. Z.; dokumente leje qëndrimi në shtetin grek.

UKT-ja⁵³ ka konfirmuar se kontrata me nr. *** është në emër të shtetasit A.Z. për objektin me adresë: rruga “****”, Tiranë, me status “aktiv”. Nga regjistri i kontraktuesve kjo adresë ndodhet te pallatet “****” sh.p.k.

FSHU-ja⁵⁴ ka konfirmuar se kontrata nr. *** me kod klienti *** i përket subjektit “****”, kontratë e hapur në datën 16.3.2006.

13.4 Komisioni ka komunikuar me rrugë elektronike me shtetasin D.L., administratorin e shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k.,⁵⁵ ku është pyetur nëse shtetasit Marjeta dhe B.Z. kanë lidhur kontrata/aktmarrëveshje me këtë shoqëri.

Administratori i shoqërisë z. D.L., me rrugë elektronike në datën 16.11.2020, ka shpjeguar se nuk ka lidhur kontratë me shtetasit Marjeta dhe B.Z., por në datën 20.6.2008 është lidhur kontrata me shtetasit A. dhe E.Z., si dhe ka bashkëngjitur kontratën e shitblerjes së apartamentit e lidhur në vitin 2008, e cila ishte administruar më parë nga Komisioni.

13.5 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se për shkak të përdorimit pa dhe me kundërshtim të apartamentit prej subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur/bashkëshortit B.Z., z. A.Z. bëhet person tjetër i lidhur dhe në këto kushte subjekti duhet:

a) të shpjegojë mospërputhjen e çmimit të blerjes së apartamentit në dy kontratat e depozituar prej subjektit (në kontratën e sipërmarrjes së datës 24.2.2004, lidhur me sipërmarrës shoqërinë “****” sh.p.k. dhe porositës A.Z. për apartamentin me sip.120 m² pasqyrohet çmimi i shitjes 48,000 euro, ndërsa në kontratën e shitblerjes së datës 20.6.2008 me shitës shoqërinë “****” sh.p.k. dhe blerës A.Z. është pasqyruar çmimi i shitjes 35,200 euro); dhe

b) të provojë me dokumentacion ligjor (ku vërtetohet pagimi i tatimeve dhe sigurimeve) burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. A.Z., me të cilat ka blerë apartamentin me sip. 120 m², si dhe kohën e kryerjes së pagesave dhe dokumentacionin që justifikon kryerjen e tyre.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet shoqëruar me provat shkresore, bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

13.6 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe në seancën dëgjimore, ka shpjeguar se çmimi i shënuar në kontratën e shitjes është një lapsus dhe vlera reale e pasurisë është vlera e përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes prej 48,000 euro. Kjo mospërputhje ka ardhur për shkak se mund të jetë punuar mbi një kontratë të mëparshme dhe blerësi i pasurisë nuk ka qenë i vëmendshëm në momentin e nënshkrimit të kontratës, që është bërë 3 vjet pas kryerjes së pagesës. Personi tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka depozituar dokumentacion për pagesat e kryera në shumën 48,000 euro.

Subjekti i rivlerësimit ka depozituar si dokumentacion provues për burimin e krijimit të apartamentit nga vëllai i bashkëshortit, transferimin e të hollave monetare nga z. A.Z. te shtetasi B.Xh., njëkohësisht, shok fëmijërie dhe ndërmjetës për blerjen e apartamentit. Shumat janë transferuar nga llogaria bankare në Greqi e z. A.Z. te llogaria bankare e B.Xh., në Shqipëri, në vlerat 10,000 euro, datë 10.2.2004; 10,000 euro, datë 19.4.2004; si dhe 5,000 euro në datën 20.12.2004. Këto shuma më pas janë depozituar nga shtetasi B.Xh. në zyrat e financës së shoqërisë

⁵³ UKT-ja me nr. *** prot., datë 12.11.2020.

⁵⁴ FSHU-ja me nr. *** prot., datë 6.11.2020.

⁵⁵ Korrespondenca e kryer me z. D.L., admistratori i “****” sh.p.k., me postë elektronike.

së ndërtimit. Këto depozitime vërtetohen me mandatpagesat e dorëzuara nga subjekti. Gjithashtu, për pagesën e pjesës së mbetur të apartamentit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar edhe dy mandatpagesa të tjera në shumat 5,000 euro në datën 14.6.2004 dhe 17,500 euro në datë 5.5.2005. Si burim për këto pagesa ka shërbyer gjendja në llogarinë bankare e vëllait të bashkëshortit, në “Raiffeisen Bank” në Shqipëri, ku konfirmohet se ka tërhequr nga llogaria e tij shumat e nevojshme për pagesat e kryera. Subjekti ka depozituar edhe dokumentacion nga sigurimet shoqërore greke për të provuar marrëdhënien e punësimit të z. A.Z., në Greqi.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

13.7 Komisioni vlerëson se subjekti ka pranuar konstatimin e Komisionit, si dhe ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe ka provuar se vlera e apartamentit është 48,000 euro. Në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të vëllait të bashkëshortit, z. A.Z., subjekti ka dhënë shpjegime të plota dhe ka provuar me dokumentacion pagesat e kryera për llogari të tij.

Komisioni arriti ne konkluzionin se apartamenti me vendndodhje rruga “**”, pallatet “****”, Njësia Bashkiake Nr. ***, Tiranë, është pasuri në pronësi të vëllait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. A.Z.**

14. Në lidhje me deklarinimin e gjendjeve cash të deklaruara në deklaratat periodike vjetore ndër vite.

14.1 Në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, subjekti ka deklaruar: *“Depozita me afat të depozituar prej bashkëshortit tim 1,800,000 lekë. Burim: të ardhura të akumulura vit pas viti. “Të ardhura vjetore në milion/lekë ose valutë“ 0.631.740 lekë”.*

14.2 E pyetur nga Komisioni, të shpjegojë në lidhje me shumën 0.631.740 lekë të deklaruar në deklaratën e vitit 2003, subjekti ka shpjeguar se: *“Vlera 0.631.740 (zero pikë gjashtëqind e tridhjetë e një mijë e shtatëqind e dyzetë) lekë, e pasqyruar në faqen 8 të deklaratës së vitit 2003, në Formularin A-5, ku flitet për ‘Likuiditete’, është vlera e kursimeve nga paga ime dhe nga të ardhurat e bashkëshortit tim (nga paga dhe të ardhura si ekspert), si dhe interesat bankare të përfituara nga depozitat e çelura prej bashkëshortit tim në Tirana Bank, për vitin 2003.*

Duke mos e kuptuar në atë kohë që kjo vlerë duhej të paraqitej si gjendje në cash, nga ana ime është pasqyruar e gjithë shuma e kursimeve në kolonën e deklaratës ku flitej për të ardhurat vjetore për pasurinë e deklaruar prej meje si depozita me afat. Një pjesë e kësaj shume, vlera prej 600,000 në datën 22.4.2004, në vitin pasardhës, është depozituar në ‘Tirana Bank’ prej bashkëshortit tim”.

14.3 Në DIPP e vitit 2008, subjekti ka deklaruar: *“Shuma 1,500,000 lekë të ardhura cash, një pjesë e kontratës paraprake të shitjes”.*

Subjekti ka dhënë sqarime në ILDKPKI, në lidhje me gjendjen cash sipas procesverbalit të datës 18.4.2016, ku ka deklaruar se: *“Për sa i përket gjendjes cash deklarohet se në vitin 2008 kam pasur gjendje në banesë 3,100,000 lekë pasi në datë 31.10.2008 unë kam tërhequr depozitën në ‘Tirana Bank’ në shumën prej 1,662,690 lekë të cilën e kam deklaruar si të ardhur në deklaratën e vitit 2008 duke mos ja shtuar gjendjes cash prej 1,500,000 lekë”.*

14.4 Në DIPP e vitit 2009, subjekti ka deklaruar: “Shuma 3,500,000 lekë të ardhura cash (një pjesë e të ardhurave të tërhequra nga depozitat e deklaruar në vitin 2009 së bashku me të ardhurat e deklaruar po atë vit, si dhe depozitën e tërhequr dhe të deklaruar më sipër⁵⁶”.

E pyetur nga Komisioni,⁵⁷ për burimin e krijimit, subjekti ka sqaruar se: “Referuar pyetjes dhe duke u konsultuar me DIPP e vitit 2009, kam konstatuar se pjesa e të ardhurave të tërhequra nga depozitat e deklaruar në vitin 2009 dhe të përshkruara për atë vit, (referuar edhe shpjegimit me fjalë), janë të ardhura për vitin 2008. Shënimi i vitit 2009 është pasaktësi (pakuja). Kjo pasi në vitin 2009 është tërhequr vetëm depozita e çelur prej meje në ‘Raiffeisen Bank’ në datën 30.1.2009, në vlerën 659,500 lekë, e saktësisht të ardhurat që kanë shërbyer për krijimin e shumës cash në vitin 2009, në vlerën 3,500,000 lekë janë: (i) depozita e tërhequr më 4.11.2008, nga ‘Tirana Bank’ prej bashkëshortit tim B.Z. në vlerën 1,662,600 lekë; (ii) pjesa e të ardhurave cash të mbetura nga shitja e banesës në vitin 2008, në shumën 500,000 lekë (pas kthimit të vlerës tek blerësi, si rrjedhojë e ndryshimit të çmimit të shitjes së apartamentit të ndodhur në Fier nga shitja paraprake). Në këtë vlerë përfshihet edhe gjendja cash në fund të vitit 2008 lekë; (iii) depozita e tërhequr prej meje nga ‘Raiffeisen Bank’ në datën 30.1.2009, në vlerën 659,500 lekë; (iv) të ardhura cash të krijuara nga të ardhurat gjatë vitit 2009 (pagat dhe shpërblimet), në vlerën 650, 000 lekë.”

Në procesverbalin e datës 18.4.2016 në ILDKPKI, subjekti vijon me deklarin “[...] Këtë ndryshim e kam bërë në deklaratën e vitit 2009 duke deklaruar gjendjen reale cash, duke shtuar edhe kursimet e vitit 2009 në shumën totale prej 3,500,000 lekësh, por edhe këtu duhet të shtoj se pakësimin e depozitës në ‘Raiffeisen Bank’ në datën 26.1.2009, në shumën 660,681 lekë, të cilën e kam deklaruar si të ardhur, faktikisht këtë shumë e kam pasur si shtesë për vitin 2009 duke e pasur gjendjen totale cash në banesë në fund të vitit 2009 në shumën 4,160,681 lekë”.

14.5 Në DIPP e vitit 2010, subjekti ka deklaruar: “Shumën 950,000 lekë të ardhura cash me burim krijimi kursimet nga pagat dhe të ardhurat e tjera të deklaruar”.

Në DIPP e vitit 2011, subjekti ka deklaruar: “Shumën 400,000 lekë të ardhura cash me burim krijimi kursime nga paga dhe të ardhurat e tjera të deklaruar. Pakësimi i gjendjes cash në shumën 2,494,000 lekë”.

Subjekti, e pyetur nga Komisioni për burimin e krijimit, ka shpjeguar se: “(i) në datën 11.1.2010, është mbyllur prej meje llogaria e pagës e çelur në datën 1.4.2005, në ‘Raiffeisen Bank’, Fier dhe është tërhequr shuma e mbetur në llogari në vlerën **433.000** lekë; (ii) në datën 3.3.2010, është tërhequr prej bashkëshortit tim, B.Z., depozita e çelur në ‘Tirana Bank’ në vitin 2008, në vlerën 1,794,700 lekë, me burim krijimi, një pjesë e shumës së përfituar nga shitja e banesës në Fier. Për rrjedhojë, në vitin 2010, duke përfshirë edhe të ardhurat cash në vlerën 950,000 lekë, unë kam pasur gjendje në banesë një shumë më të madhe se 2,500,000 lekë, shumë e cila më datën 13.5.2011, është depozituar në BKT, në depozitën që është krijuar për kredinë”.

Sipas deklarinimit në procesverbalin e datës 18.4.2016 dhënë në ILDKPKI, ka shpjeguar se: “Në vitin 2010 gjendja cash në banesë ka qenë në shumën 950,000 lekë duke e pakësuar gjendjen cash të vitit 2009. Destinacioni i pakësimit ka qenë hapja e depozitave në ‘Raiffeisen Bank’, në shumën 1,000,000 lekë, në BKT në shumën 1,000,000 lekë, ‘Intesa Sanpaolo Bank’ depozitë 600,000 lekë, si dhe blerje automjeti në shumën 900,000 lekë, duke na mbetur nga gjendja e cash-it e vitit 2009

⁵⁶ Deklaron në deklaratën periodike: “Depozitë e tërhequr në ‘Raiffeisen Bank’, në datën 26.01.2009, në shumën 660,681 lekë”.

⁵⁷ Me pyetësonin nr. 2.

shuma prej 660,000 lekë me të cilën kemi shlyer një pjesë të kështit për blerësin e banesës sipas marrëveshjes të cilën e kam sqaruar më lart. Në këtë mënyrë gjithë kursimet nga viti 2009 u bënë 0. Pra shuma prej 950,000 lekë ka qenë kursime nga të ardhurat e vitit 2010. Në vitin 2011 kam deklaruar "pakësuar cash shumën 2,494,000 lekë" kam pasqyruar pakësimet në tërësinë e vet duke llogaritur si gjendjen cash ashtu edhe pakësimet në sistemin bankar. Deklarata 'cash 400,000 lekë' e deklaruar, ka pasur si qëllim të pasqyrojë kursimet e vitit 2011, por kjo shumë ka qenë e llogaritur brenda shumës prej 2,494,000 lekë e cila u pakësua në vitin 2011 pasi ka kaluar për shlyerjen e detyrimit për vlerën e mbetur nga kontrata e shitjes së banesës në Fier. Në këtë mënyrë në dt.31.12.2011 ka qenë zero".

Në të njëjtin procesverbal, disa rreshta më poshtë, subjekti deklaron si burim për pakësimin e gjendjes cash në shumën 2,494,000 lekë: " ...dhe vlera prej 2,494,000 lekë e cila ka qenë gjendje cash prej 950,000 lekë dhe afërsisht 1,600,000 lekë ndihma e familjarëve të mi".

Gjithashtu, subjekti i pyetur nga Komisioni,⁵⁸ në lidhje me ndihmën familjare, ndër të tjera, ka deklaruar se: " [...] sipas DIPP për vitin 2008, në rubrikën të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike/ose veprimtari private (faqe *** e Deklaratës) unë kam deklaruar si gjendje Cash shumën 1,500,000 lekë, e cila ka pasur si burim një pjesë të të ardhurave të siguruara nga kontrata paraprake e shitjes (1,350,000 lekë dhe kursime nga të ardhurat vjetore. Gjithashtu edhe vlerën 1,662,690 lekë lekë, që ka pasur si burim depozitën e tërhequr nga Tirana Bank më datën 31.10.2008. Gjendja totale cash sipas DIPP 2008 është 3,162,690 lekë.... Por lidhur me gjendjen e të ardhurave Cash, të deklaruara në Deklaratën e Interesave Private Periodik/Vjetor të Pasurisë të vitit 2011 si pakësim në vlerën 2,494,000 lekë (2,500.000 lekë), sqaroj se ajo është gjendja e depozitës së tërhequr në vitin 2010 prej Tirana Bank prej bashkëshortit tim dhe mbyllja e llogarisë time bankare të pagës në Raiffeisen Bank në vitin 2010. Për rrjedhojë në vitin 2010, duke përfshirë edhe të ardhurat Cash në vlerën 950,000 lekë të deklaruara prej meje në DIPP për vitin 2010, unë kam pasur gjendje në banesë një shumë më të madhe se **2,500,000 lekë**, shumë e cila më datën 13.05.2011, është depozituar në BKT Bank, në depozitën që është krijuar për kredinë, me të cilën është bërë pagesa e datës 8.6.2011 për shoqërinë "****" sh.p.k në shumën 2,500,000".

14.6 Komisioni gjatë hetimit administrativ ka konstatuar se ka mospërputhje deklarimi, në lidhje me gjendjen cash të deklaruar në deklaratat periodike në procesverbalin e datës 18.4.2016 mbajtur në ILDKPKI dhe në shpjegimet e dhëna në pyetësor, nga subjekti i rivlerësimit, si vijon:

- i) në deklaratën e vitit 2003, subjekti nuk deklaron gjendje cash, ndërsa në pyetësorin nr. 2 deklaron shumën 631,740 lekë si gjendje cash;
- ii) në DIPP-në e vitit 2008, subjekti deklaron gjendje cash në shumën 1,500,000 lekë, ndërsa në procesverbalin e datës 18.4.2016 mbajtur në ILDKPKI, si dhe në shpjegimet e dhëna në pyetësor deklaron gjendje cash në shumën 3,162,690 lekë (1,662,690+1,500,000);
- iii) në DIPP-në e vitit 2009, subjekti deklaron gjendje cash në shumën 3,500,000 lekë, në procesverbalin e datës 18.4.2016 mbajtur në ILDKPKI deklaron gjendje cash në shumën 4,160,681 lekë, ndërsa në shpjegimet e dhëna në pyetësor deklaron gjendje cash në shumën 3,472,100 lekë;

⁵⁸ Në pyetësorin nr. 3.

iv) në DIPP-në e vitit 2010 dhe në procesverbalin e datës 18.4.2016 mbajtur në ILDKPKI, subjekti deklaroi gjendje *cash* në shumën 950,000 lekë, ndërsa në shpjegimet e dhëna në pyetësor deklaroi gjendje *cash* në shumën 3,177,700 lekë;

v) në DIPP-në e vitit 2011, subjekti deklaroi gjendje *cash* në vlerën 400,000 lekë, ndërsa në procesverbalin e datës 18.4.2016 mbajtur në ILDKPKI deklaroi gjendje *cash* 0 (zero) lekë.

Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, pas kalimit të barrës së provës me rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe në seancën dëgjimore, ka shpjeguar se:

a) deklarimi i kursimeve të vitit 2003, “ të ardhura vjetore në milion/lek në shumën 0,631.740”⁵⁹, jo në rubrikën e duhur, por gjithsesi në të njëjtin formular A-5 “Likuiditet”, tregon pikërisht gjendjen *cash*;

b) lidhur me konstatimin e Komisionit se në DIPP-në e vitit 2008, gjendja *cash* është në shumën 1,500,000 lekë, ky konstatim nuk qëndron, pasi në faqen nr. *** të deklaratës janë deklaruar dy shtesat e gjendjes *cash*. Shtesa e parë e gjendjes *cash* i referohet depozitës së tërhequr në “Tirana Bank”, në shumën 1,662,690 lekë dhe shtesa e dytë është nga pjesa e kontratës paraprake të shitjes në shumën 1,500,000 lekë;

c) në lidhje me gjendjen *cash* për vitin 2009, subjekti shpjegon se Komisioni duhet të i referohet deklaratimit në DIPP-në e vitit 2009 dhe shpjegimeve të dhëna në pyetësor. Në përshkrimin e dhënë në DIPP-në e vitit 2009 “*Të Ardhura cash (një pjesë e të ardhurave të tërhequra nga depozitat bankare të deklaruara në vitin 2009 së bashku me të ardhurat e deklaruara po atë vit si dhe depozitën e tërhequr dhe deklaruar në paragrafin më sipër)*”, është e qartë se viti 2009 është shënuar gabim pasi i korrespondon tërheqjeve të bëra në vitin 2008. Ajo që e bën më bindës, që kemi të bëjmë me deklaratim të gabuar të vitit, është vazhdimi i deklaratimit ku, më tej, citohet se pjesë përbërëse e gjendjes *cash* në vitin 2009 është edhe depozita e tërhequr në këtë vit;

d) gjendja *cash* në fund të vitit 2010, referuar deklaratimeve në vitet përkatëse 2009 dhe 2010, është në shumën 3,450,000 lekë (3.500.000 lekë që përfaqëson gjendjen *cash* në fund të vitit 2009, duke shtuar shumën 950.000 lekë që janë shtesa nga kursimet nga paga dhe të ardhurat e tjera referuar edhe burimit të krijimit në DIPP-në e vitit 2010 dhe pakësohet me depozitën e krijuar pranë BKT-së në shumën 1.000.000 lekë në datën 25.10.2010);

e) në lidhje me gjendjen *cash* në vitin 2011, subjekti shpjegon se duhet marrë sipas deklaratimit në deklaratën periodike dhe jo sipas shpjegimeve të dhëna në ILDKPKI, për shkak se deklarimi është bërë në mungesë të dokumentacionit.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

14.8 Komisioni vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me gjendjen *cash* në vitin 2003, duke arsyetuar se deklarimi jo në rubrikën e duhur, nuk mund të konsiderohet mosdeklarim. Për këtë arsye, Komisioni ka marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna nga subjekti duke përfshirë në analizën financiare shumën prej 631,740 lekësh si kursime *cash* për vitin 2003.

Në lidhje me gjendjen *cash* për vitin 2008, Komisioni vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit janë bindëse. Këto shpjegime u vlerësuan në kuadër edhe të hetimit të kryer mbi pasurinë, nga ku rezulton se deri në fund të vitit 2008⁶⁰ subjekti nuk ka krijuar asnjë pasuri tjetër

⁵⁹ Shprehur kjo në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 faqe nr. ***

⁶⁰ Tërheqja e depozitës në vlerën 1,662,000 lekë është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2008.

ku mund të jetë shpenzuar tërheqja e depozitës bankare në “Tirana Bank” në shumën 1,662,000 lekë.

Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime në lidhje me gjendjen *cash* të vitit 2009. Shpjegimi se deklarimi në DIPP-në e vitit 2009 përfshin edhe depozitat e tërhequra në vitin 2008, përveç depozitës së tërhequr në vitin 2009 në “Raiffeisen Bank”, qëndron, pasi nga mënyra e deklarimit duket se subjekti është përpjekur të identifikojë depozitat që kanë shërbyer si pjesë përbërëse e gjendjes *cash*. Nga verifikimi i tërheqjeve bankare në vitin 2009, rezulton se nuk ka tërheqje të tjera përveç tërheqjes së datës 29.1.2009 në “Raiffeisen Bank”. Pra, kjo do të thotë se tërheqjet bankare në pjesën e parë të deklarimit nuk mund të jenë të vitit 2009, por janë të vitit 2008.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me gjendjen *cash* në fund të vitit 2010, të cilat janë shpjeguar në mënyrë shteruese në pikën 7.15 të vendimit.

Gjithashtu, Komisioni vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me deklarimin e gjendjes *cash* për vitin 2011.

Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me situatën e gjendjes *cash*. Këto shpjegime u morën në konsideratë nga Komisioni dhe u pasqyruan në analizën financiare të subjektit (shihni analizën financiare në pikën 16 të vendimit).

15. Në lidhje me depozitën me afat të depozituar prej bashkëshortit të subjektit, në shumën 1,800,000 lekë, me burim të ardhurat e akumuluar vit pas viti

15.1 Në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, subjekti ka deklaruar: “*Depozita me afat të depozituar prej bashkëshortit tim në shumën 1,800,000 lekë me burim të ardhura të akumulura vit pas viti. 0.631.740 lekë “Të ardhura vjetore në milion/lekë ose valutë”.* Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: “*Shumën 1,800,000 lekë të ardhura nga puna si ekspert pranë Gjykatave të Rrethit Gjyqësor Fier dhe Lushnjë për periudhën 1998 deri në muajin prill 2003, të cilat janë depozituar pranë Tirana Bank në vitin 2003 dhe të deklaruar në deklaratën vjetore të atij viti”.*”

15.2 Komisioni ka kërkuar⁶¹ nga subjekti të provojë me dokumentacion ligjor të ardhurat e bashkëshortit si ekspert topograf, e cila ka shpjeguar se: “*Në deklaratën e vitit 2003, si dhe në deklaratën e pasurisë së dorëzuar në kuadër të procesit të rivlerësimit (Vetting), kam deklaruar të ardhurat e bashkëshortit vit pas viti, si edhe të ardhurat për vitet 1998 deri 2003, të cilat janë përfshirë në kursimet e familjes, që kanë shërbyer në çeljen e depozitave në Tirana Bank, në shumën 1,800,000 lekë. Për këtë arsye kam dorëzuar me cilësinë e dokumentit dy vërtetime të gjykatës, që konfirmojnë se ai ka punuar për periudhën prill 1998 deri në maj 2003, si ekspert topograf pranë Gjykatave Fier dhe Lushnje, si edhe kopjen e licencës ***. Vlera e të ardhurave të përfituara prej bashkëshortit tim për periudhën prill 1998 deri në maj 2003, në dijeninë time më të mirë, është rreth 950,000 (nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë”.*”

15.3 Komisioni ka administruar përgjigjen e DRT-së Fier,⁶² ku rezultoi se për shtetasin B.Z. nuk disponohen të dhëna lidhur me regjistrimin si biznes me aktivitet “ekspert-topograf”, për periudhën 1998 – 2003.

⁶¹ Me pyetësin nr. 2.

⁶² DRT-ja Fier me nr. *** prot., datë 12.10.2020.

15.4 Komisioni ka analizuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit për krijimin e kursimeve familjare, të cilat kanë shërbyer si burim për depozitën e deklaruar prej subjektit në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, në shumën 1,800,000 lekë.

“Tirana Bank”⁶³ konfirmon çeljen e depozitës në emër të bashkëshortit të subjektit në datën 17.12.2002, në shumën 700,000 lekë. Në vitin 2003 kjo depozitë është shtuar me shumën 1,100,000 lekë nga depozitimi; me shumën 700,000 lekë, në datën 17.04.2003; si dhe shumën 400,000 lekë, në datën 23.12.2003.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion provues në lidhje me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti, si ekspert topograf, në shumën 950,000 lekë.

15.5 Nga analiza financiare duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/ bashkëshorti, kanë pasur mundësi që me të ardhura të ligjshme të krijojnë depozitën prej 700,000 lekësh, çelur në datën 17.12.2002, në “Tirana Bank”, por ato nuk kanë pasur mundësi që ta shtojnë këtë depozitë në vitin 2003 me shumën 1,100,000 lekë të ardhura të krijuara, ndër vite, pasi referuar analizës financiare ⁶⁴, mundësia për kursime deri më 31.12.2002, është në shumën 321,361 lekë, duke rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 778,639 lekë (1,100,000 – 321,361).

15.6 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti B.Z. kanë mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e depozitës në shumën - 778,639 lekë, në “Tirana Bank”.

Për konstatimin e mësipërm, subjektit të rivlerësimit, iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet shoqëruar me provat shkresore, bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

15.7 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe në seancën dëgjimore, ka shpjeguar se është në pamundësi për të siguruar informacion në lidhje me të ardhurat e përfituara nga puna e bashkëshortit si ekspert topograf, pasi nuk ka pasur detyrim të regjistrohej në organin tatimor si person fizik.

Në lidhje me pagesën e tatimit në burim DRT-ja Fier nuk konfirmon pagesa të tatimit në burim, pasi për periudhën 1998 – 2003 nuk disponohen të dhëna në kontabilitet. Për pagesat e kryera në bankat e nivelit të dytë në sportelin e arkës, ka kaluar afati i ruajtjes së dokumentacionit, ndërsa në lidhje me pagesat e tatimit të mbajtura nga zyra e financës, e cila ka vepruar si agjent tatimor, është e pamundur për të gjetur informacion për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar. Si provë se bashkëshorti ka ushtruar detyrën e ekspertit topograf, subjekti disponon disa dosje gjyqësore në të cilat rezultojnë aktekspertimet e realizuara prej tij.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

15.8 Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit, në lidhje me mospasjen e detyrimit për regjistrim si person fizik, nuk qëndrojnë, pasi subjekti ka pasur detyrim për t`u regjistruar si person fizik në momentin e ushtrimit të aktivitetit privat në bazë të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për

⁶³ “Tirana Bank” me nr. *** prot., datë 27.1.2020.

⁶⁴ Mundësia financiare për kursime deri më 31.12.2002 është në shumën 321,361 lekë (të ardhura – shpenzime – pasuri). Të ardhura totale deri në vitin 2002 janë në shumën 3,221,257 lekë, nga të cilat nga paga e subjektit 2,718,161 lekë dhe nga paga e bashkëshortit 503,096 lekë; shpenzimet jetike përlllogariten 2,181,676 lekë; pasuria totale vlerësohet në shumën 718,221 lekë, nga të cilat 18,221 lekë vlera e apartamentit të privatizuar në 1993 dhe 700,000 lekë depozitë hapur në vitin 2002, në “Tirana Bank”.

sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” i ndryshuar, neni 2 dhe 5 e vijues ⁶⁵.

Pavarësisht kalimit të afatit të ruajtjes së dokumenteve bankare të pagesës apo atyre të derdhura në zyrën e financës pranë gjykatës, DRT-ja Fier nuk konfirmon pagesën e tatimit në burim për llogari të bashkëshortit të subjektit. Gjithashtu, nga dosjet gjyqësore rezulton se z. B.Z. ka punuar si ekspert, por nuk vërtetohet që të ketë realizuar të ardhura të ligjshme me ushtrimin e këtij profesioni. Ndër të tjera, nuk ka asnjë dokument provues në lidhje me përfitimin e të ardhurave në shumën 950,000 lekë, përveçse deklaramit të kryer nga subjekti.

Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti, kanë mungesë dokumentacioni për të ardhurat nga puna si ekspert topograf i bashkëshortit dhe, për rrjedhojë, nuk provuan burimin e ligjshëm të krijimit të depozitës në shumën 778,639 lekë.

16. Analiza financiare e subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003 – 2016

Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve ne Republikën e Shqipërisë”, Njësia e Shërbimit Ligjor përgatiti analizën financiare mbështetur në të dhënat në deklaramet periodike vjetore në ILDKPKI, në deklaratën *Vetting*, në informacionet e ardhura nga institucionet përkatëse, si dhe në deklaramet e subjektit.

Znj. Marjeta Zaimi ka qenë subjekt deklarami pa ndërprerje që prej vitit 2003. Analiza shërben për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të realizuar kursimet, pasuritë e deklaruara dhe për të paguar shpenzimet, si dhe evidentimin e rasteve kur nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pasuritë e krijuara (pasuri të luajtshme, të paluajtshme, likuiditete) dhe shpenzimet e kryera. Analiza financiare e subjektit për periudhën e hetuar 2003 – 2016 bazohet:

- në të ardhurat e ligjshme për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, të cilat janë: të ardhurat nga pagat dhe honorarët në vlerë *neto* sipas vërtetimeve lëshuar nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimit⁶⁶ dhe personin e lidhur bashkëshortin⁶⁷; të ardhurat nga interesave bankarë të depozitave sipas

⁶⁵ Neni 2 përcakton: “Subjektet shqiptare ose të huaja ushtrojnë veprimtaritë private të mëposhtëmve (pa u kufizuar vetëm me to (a) si individë”); Neni 5 përcakton: “Subjektet e përmendura në nenin 2 të këtij ligji fitojnë zotërinë për të vepruar, me regjistrimin e tyre në gjykatën e rrethit ku e ushtrojnë veprimtarinë”.

⁶⁶ Vërtetim nr. *** prot., datë 18.10.2016, nga DRSSH-ja Fier për periudhën 1.11.1994 – 31.10.1995; për periudhën 16.9.1993 – 31.10.1994, e cila nuk mbulohet me vërtetim për shkak të mungesës së dokumentacionit nga institucionet përgjegjëse (periudha e punës vërtetohet me librezën e punës) të ardhurat janë llogaritur si diferencë e vlerës së të ardhurave të deklaruara nga subjekti në deklaratën *Vetting* në shumën 212,99 lekë për periudhën 1993 – 1995, me të ardhurat nga vërtetimi nr. *** prot., për periudhën 1.11.1994 – 31.10.1995, në shumën 171,334 lekë; vërtetim nr. *** prot., datë 18.10.2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për periudhën 1996 – maj 2007 (për pagat për muajt janar, prill, maj 1998 në shumën 89,664.17 lekë të cilat mungojnë në vërtetim janë llogaritur nga Komisioni referuar pagës në vërtetimin nr. *** prot., datë 18.10.2016, si dhe legjislacionit tatimor në fuqi); vërtetim, datë 18.1.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën qershor 2007 – 31.12.2016

⁶⁷ Për periudhën 1985 – 1992, e cila nuk mbulohet me vërtetim për shkak të mungesës së dokumentacionit nga institucionet përgjegjëse (periudha e punës vërtetohet me librezën e punës) të ardhurat janë llogaritur sipas deklaramit të subjektit në deklaratën *Vetting* në shumën 72,400 lekë; vërtetim nr. *** prot., datë 14.1.2020, i Repartit Ushtarak *** për periudhën 1.1.1993 – 1.3.1996; vërtetim nr. *** prot., datë 14.1.2020, nga Qendra e Personel Rekrutimit për periudhën 1.3.1996 – 28.2.1998; Bashkia Fier me nr. *** prot., datë 26.10.2016, për periudhën 1.5.1993 – 30.6.2008; Bashkia Tiranë, Njësia Administrative F. me nr. *** prot., datë 4.11.2016.

nxjerrjes së llogarive bankare; të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme sipas kontratës përfundimtare të shitjes⁶⁸.

- në rubrikën e *detyrimeve* është pasqyruar *shuma e marrë kredi* referuar kontratës së kredisë bankare në Bankën Kombëtare Tregtare⁶⁹.
- lidhur me shpenzimet e deklaruara, u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, deklaratën *Vetting*, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit. Për analizimin e shpenzimeve u morën në konsideratë: *shpenzimet e jetesës* llogaritur për familje me 4 anëtarë bazuar në shpenzimet e përcaktuara në shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së drejtuar Komisionit. Për vitin 2007 konsumi për frymë është marrë sa shpenzimi i llogaritur për vitin 2008 në vlerën 136,620 lekë; *shpenzimet e qirasë* sipas kontratës për dhënie me qira⁷⁰ dhe sipas deklaratimit të subjektit në pyetësorë⁷¹; *shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit* llogaritur bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, konkretisht lëvizjet hyrje-dalje nëpërmjet sistemit *TIMS* të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve, referuar deklarimeve të subjektit dhe dokumentacionit provues⁷² të vënë në dispozicion për udhëtimet e mbuluara nga institucioni, si dhe shpenzimet e qëndrimit të mbuluara nga persona të tretë; *shpenzimet e mobilimit* sipas deklaratimit të subjektit në pyetësorin standard dhe sqarimeve të dhëna në ILDKPKI me procesverbalin e datës 18.04.2016; *shpenzime shkollimi* sipas deklarimeve të subjektit në pyetësorin standard dhe pagesave të kryera me mandate, pas zbritjes së vlerës për shpenzimet e arsimit të përllogaritura në shpenzimet jetike; *shpenzime mjekësore* sipas shkresës nr. *** prot., datë 23.9.2019, të Spitalit A. dhe faturave tatimore për vitin 2014 me nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. *** dhe nr. ***; *kthimi i çmimit të shitjes së apartamentit* në vlerën 1,000,240 lekë sipas deklaratimit të subjektit.
- lidhur me *pasuritë* e krijuara dhe *kursimet* e deklaruara, u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, deklaratën *Vetting*, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit. *Kursimet cash* u morën në konsideratë sipas deklarimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë dhe shpjegimet e dhëna gjatë hetimit, ndërsa *likuiditetet* në

⁶⁸ Kontratë përfundimtare e shitjes nr. ***, datë 2.6.2009.

⁶⁹ Kontratë kredie bankare nr. ***, datë 2.6.2011, në BKT.

⁷⁰ Kontratë qiraje nr. ***, datë 16.7.2007, me qiradhënë Q.K. dhe qiramarrës B.Z. për periudhën 1.7.2007 – 1.6.2008.

⁷¹ Deklaron në pyetësorin nr. 2: “Nga data 1.12.2004 – 1.5.2007, kam banuar së bashku me familjen time me qira në banesën e shtetasit I.I.LL., me adresë: lagjja “***”, rruga “****”, Njësia Administrative Nr. ***, Fier. Me shtetasin I.LL. nuk kemi bërë kontratë qiraje gjatë kohës së qëndrimit në këtë banesë, por detyrimi ka qene në vlerën 10,000 (dhjetë mijë) lekë/ muaj, i cili është shlyer çdo 3 (tre) muaj”;

“Nga data 1.6.2008 – 1.6.2010, kam banuar së bashku me familjen time me qira në banesën e shtetasit A.Z., i cili është kunati im (vëllai i bashkëshortit dhe është emigrant në Greqi), Banesa ndodhet në rrugën “****”, pallatet “****”, Njësia Bashkiake Nr. ***, Tiranë, nr. pasurie ***, z. k. ***. Me shtetasin A.Z. nuk kemi bërë kontratë qiraje gjatë kohës së qëndrimit në këtë banesë, por detyrimi ka qene në vlerën 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë lekë) në muaj, i cili është shlyer në fund të çdo viti”.

⁷² Biletë udhëtimi me “A.A.” për Marjeta dhe B.Z. për udhëtimin Tiranë-Vjenë në periudhën 3.8.2005 – 10.8.2005 me çmimin 268.17 euro/personi; notëverbale nr. *** prot., datë 6.6.2006, e Prokurorit të Përgjithshëm, drejtuar Republikës Arabe të Egjiptit; urdhër nr. ***, datë 23.6.2008, i Prokurorit të Përgjithshëm; urdhër nr. ***, datë 14.01.2010, i Prokurorisë së Përgjithshme; urdhër nr. ***, datë 15.01.2011, i Prokurorisë së Përgjithshme; urdhër nr. ***, datë 16.11.2011, i Prokurorisë së Përgjithshme.

bankë sipas pasqyrave të lëvizjeve bankare të individëve. Në analizën financiare kemi pasqyruar ndryshimin e zërit likuiditete, pra, shtesën ose pakësimin e ndodhur gjatë vitit përkatës në likuiditete(*bank+cash*). *Pasuritë e luajtshme*⁷³ dhe të *paluajtshme*⁷⁴ të krijuara për

- periudhën 2003 – 2016, sipas vlerave referuar kontratave të shitblerjes dhe dokumentacionit financiar.

16.1 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë në shumën totale prej 2,349,336 lekësh, për periudhën e hetimit 2003 – 2016, pasi analiza financiare e kryer nga Komisioni rezultoi me balancë negative.

Për konstatimin e mësipërm, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet shoqëruar me provat shkresore, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

16.2 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe në seancën dëgjimore, ka shpjeguar se në analizën financiare për periudhën 2003 – korrik 2008, duhet të përfshihen të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti si anëtar i Këshillit të Rregullimit të Territorit, Bashkia Fier, bazuar në vërtetimin nr. *** prot., datë 15.1.2021.

Në analizën financiare të vitit 2010 nuk duhet të përfshihet kthimi i diferencës së çmimit të shitjes së apartamentit në Fier dhe kjo shumë duhet të përfshihet në analizën e vitit 2009, siç është pranuar edhe nga blerësi. Kthimi i diferencës është kryer në vitin 2009, duke u reflektuar në gjendjen *cash* në fund të vitit.

Gjendja *cash* në fund të vitit duhet të jetë në shumën 3,450,000 lekë dhe jo në shumën 950,000 lekë, sikurse është sqaruar më sipër, duke ndikuar edhe në ndryshimin e likuiditetit për këtë vit.

Në analizën financiare për vitin 2014 dhe në vitet vijuese, Komisioni nuk duhet të përfshijë tarifën vjetore të shpenzimeve të shkollimit për djalin, pasi, ato janë përfshirë në shpenzimet jetike sipas ILDKPKI, referuar shkresës nr. *** prot., datë 4.3.2019, drejtuar Komisionit ku arsimi zë 4.2% të shpenzimit mujor.

Balanca negative që rezulton në këtë vit është mbuluar nga kontributet e familjarëve që sipas traditës tonë zakonore kanë vizituar subjektin pas ndërhyrjes kirurgjikale.

Në analizën financiare për vitin 2016, Komisioni duhet të përfshijë të ardhurat nga paga e djalit në shumën 89,909 lekë, të dokumentuara në llogarinë bankare në “Credins Bank”, si dhe me vërtetimin e nxjerrë nga *e-albania* në datën 13.01.2021.

⁷³ Kontratë shitblerje automjeti nr. ***, datë 6.7.2010, me shitës B.K. dhe blerës B.Z. me çmimin 4,000 euro dhe deklarimi në deklaratën periodike të vitit 2010 “*Detyrimet doganore së bashku me taksat e ndryshme 374,100 lekë*”.

⁷⁴ Kontratë për privatizimin e banesës, datë 30.12.1993; kontratë shitblerje me rezervë e pasurisë së paluajtshme me nr. ***, datë 22.4.2011, me shitës shoqërinë “****” sh.p.k., dhe blerës shtetasit B. dhe Marjeta Zaimi për blerje apartamenti me çmimin 87,750 euro; vlera e apartamentit është pasqyruar si total i pagesave: (1) 5,000,000 lekë e përfituar nga kredia e marrë në BKT, transferuar në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., datë 9.6.2011; (2) pagesën prej 2,500,000 lekësh në llogari të subjektit në BKT transferuar në llogarinë shoqërisë “****” sh.p.k., sh.p.k., datë 8.6.2011; (3)Pagesa prej 23,000 euro derdhur nga Marjeta Zaimi në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., datë 22.6.2011; (4) pagesa prej 1,200,000 lekësh në llogari të subjektit në “Raiffeisen Bank” transferuar në llogarinë shoqërisë “****” sh.p.k., datë 20.10.2011.

Në lidhje me ndryshimin e likuiditeteve për vitin 2003, subjekti pretendon se mundësia e kursimit për periudhën para 2003 është në vlerën 1,100,000 lekë dhe jo 321,361 lekë, pasi duhen përfshirë edhe të ardhurat prej 950,000 lekë të përfituara nga bashkëshorti si topograf.

16.3 Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit, në lidhje me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i saj si anëtar i Këshillit të Rregullimit të Territorit Bashkia Fier, qëndrojnë dhe janë të provuara me dokumentacion ligjor, për këtë arsye, Komisioni i merr në konsideratë këto të ardhura në analizën financiare, duke i llogaritur ato në vlerën *neto*.

Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, në lidhje me kthimin e diferencës së çmimit prej 1,000,240 lekësh në vitin 2009, janë analizuar në pikën 7.19.11 të vendimit dhe janë marrë në konsideratë nga Komisioni në analizën financiare.

Shpjegimet e dhëna nga subjekti, në lidhje me gjendjen *cash* për vitin 2010, qëndrojnë dhe janë argumentuar në pikën 7.15 të vendimit.

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, në lidhje me shpenzimet e shkollimit për vitin 2014 dhe në vitet vijuese qëndrojnë dhe, Komisioni merr në konsideratë pretendimin, duke i zbritur 4.2% të shpenzimeve jetike për të gjithë periudhën e shkollimit.

Në lidhje me kontributet e familjarëve për vizitat e kryera me rastin e ndërhyrjes kirurgjikale të kryer nga subjekti, Komisioni vëren se ato nuk janë deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2014 dhe, si të tilla, nuk mund të merren në konsideratë.

Komisioni vëren se pretendimi i subjektit në lidhje me pagat e përfituara nga djali qëndron dhe është i mbështetur në prova. Komisioni i merr në konsideratë këto të ardhura në analizën financiare.

Shpjegimet e dhëna, në lidhje me ndryshimin e likuiditeteve për vitin 2003, nuk qëndrojnë pasi subjekti nuk arriti të provonte përfitimin e të ardhurave në shumën 950,000 lekë dhe pagesën e tatimit për këto të ardhura.

Në përfundim të analizës financiare të rishikuar, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh të ligjshme në shumën -1,001,382 lekë.

Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Të ardhurat	1,006,534	1,416,367	1,610,477	1,672,875	1,544,674	4,813,992	1,884,424	2,035,314	2,325,438	1,751,103	1,167,034	1,372,908	1,365,279	1,453,484
Të ardhura nga paga e subjektit	716,153	978,628	1,160,686	1,187,891	977,827	1,250,811	1,210,205	1,436,695	1,672,926	1,403,088	1,167,034	1,372,908	1,365,279	1,363,575
Të ardhura nga paga e b/sh	178,821	289,844	294,324	341,655	417,346	374,148	414,449	412,748	433,639	260,207	-	-	-	-
Të ardhura nga pjesëmarrja në KKRT	27,000	32,400	32,400	32,400	32,400	18,900	-	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura nga paga e djalit	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	89,909
Të ardhura nga qiraja e shtëpisë në Fier	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura nga interesat	84,560	115,495	123,067	110,929	117,101	170,133	259,770	185,871	218,873	87,808	-	-	-	-
Të ardhura nga shitja e banesës	-	-	-	-	-	3,000,000	-	-	-	-	-	-	-	-
Detyrime	-	-	-	-	-	-	-	-	5,000,000	-	-	-	-	-
Kredi në BKT dt.07.06.2011 5,000,000 lekë	-	-	-	-	-	-	-	-	5,000,000	-	-	-	-	-
Shpenzime	375,456	985,302	644,006	558,228	896,480	819,593	1,777,485	1,095,580	1,076,543	1,563,191	971,076	1,435,166	1,292,995	1,365,417
Shpenzime jetike	375,456	375,456	438,228	438,228	546,480	546,480	546,480	546,480	546,480	564,096	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime qiraje në Fier	-	30,000	120,000	120,000	20,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzime qiraje në Tiranë	-	-	-	-	150,000	125,000	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzime qiraje në Tiranë te vëllai i b/sh	-	-	-	-	-	105,000	180,000	75,000	-	-	-	-	-	-
Pagesë e tarifës për titullin avokat 23.03.2010	-	-	-	-	-	-	-	100,000	-	-	-	-	-	-
Shpenzime për kredinë	-	-	-	-	-	-	-	-	271,163	388,095	389,313	389,360	389,533	389,244
Shpenzime mobilimi	-	500,000	-	-	-	-	-	-	258,900	611,000	-	-	-	-
Shpenzime shkollimi *****	-	-	-	-	180,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzime shkollimi *****	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	37,153	37,153	37,153	75,300
Zbritje e shpenzimeve për shkollim 4,2 %	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	(23,692)	(36,960)	(37,678)	(39,495)
Shpenzim tatim për të ardhurat nga shitja e banesës	-	-	-	-	-	-	50,765	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzime shëndetësore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	165,620	-	-
Shpenzime udhëtimi	-	79,846	85,778	-	-	43,113	-	-	-	-	4,206	-	6,883	-
Shpenzime doganore dhe të tjera për mjetin	-	-	-	-	-	-	-	374,100	-	-	-	-	-	-
Kthimi i çmimit të shitjes së ap.	-	-	-	-	-	-	1,000,240	-	-	-	-	-	-	-
Pasuri	1,436,081	(509,565)	836,686	963,611	561,031	4,005,088	5,558	1,062,856	5,056,577	(839,001)	(358)	312	844	39,196
Kursime (ndryshim likuiditete)	1,436,081	(509,565)	836,686	963,611	561,031	4,005,088	5,558	515,976	(6,893,553)	(839,001)	(358)	312	844	39,196
Shtëpi banimi e ndërtuar para vitit 1990 me sip. 85 m2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Automjet tip Benz *****	-	-	-	-	-	-	-	546,880	-	-	-	-	-	-
Apartament 103 m2, ZK *****, Selitë	-	-	-	-	-	-	-	-	11,950,130	-	-	-	-	-
Të ardhura + detyrime - shpenzime - pasuri	-805,002	940,630	129,784	151,036	87,163	-10,689	101,381	-123,121	1,192,318	1,026,913	196,316	-62,569	71,441	48,871

B. KONTROLLI I FIGURËS

17. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka dërguar pranë Komisionit, me shkresën nr. *** prot., datë 2.7.2020, raportin mbi kontrollin e figurës nr. *** prot, datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, znj. Marjeta Zaimi, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 30.6.2020, të KDZH-së.

17.1 Grupi i Punës ka konkluduar se: *“Për subjektin e rivlerësimit, znj. Marjeta Zaimi, nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Marjeta Zaimi”.*

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

17.2 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elementë që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si prokuror.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Rivlerësimi profesional është i bazuar në raportin e përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vazhdim, KLP), si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

18.1 KLP-ja ka hartuar raportin vlerësues nr. *** prot., datë 24.2.2020, për subjektin Marjeta Zaimi, ku janë analizuar:

- a) aftësitë profesionale⁷⁵;
- b) aftësitë organizative⁷⁶;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale⁷⁷; si dhe
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional⁷⁸.

⁷⁵ Aftësitë profesionale: (a) njohuritë ligjore – subjekti Marjeta Zaimi ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit; (b) arsyetimi ligjor – subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetimin ligjor të akteve.

⁷⁶ Aftësitë organizative: (a) aftësia për të përballuar ngarkesën në punë – subjekti i rivlerësimit ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë; (b) aftësia për të kryer procedurat hetimore – subjekti i rivlerësimit ka kryer veprimet e duhura hetimore në kohë të arsyeshme; (c) aftësia për të administruar dosjet – subjekti i rivlerësimit ka aftësi të mira në drejtim të hetimeve dhe rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar.

⁷⁷ Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale: (a) etika në punë – rezulton se janë përmbushur me korrektesë kërkesat për disiplinën e punës dhe të gjithë angazhimet profesionale; (b) integriteti – nuk ka të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm; (c) paanësia – nuk janë evidentuar raste konflikti interesi apo papajtueshmëri për pjesëmarrje në procedime.

⁷⁸ Aftësitë personale dhe angazhimi profesional: (a) aftësitë e komunikimit – subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës së vlerësimit ka shfaqur aftësi komunikuese të mira; (b) aftësia për të bashkëpunuar – bashkëpunimi, sjellja ndaj eprorëve, kolegëve vartësve dhe administratës ka qenë korrekte duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e tyre; (c) gatishmëria për t’u angazhuar – subjekti ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh brenda dhe jashtë Shkollës së Magjistraturës.

18.2 Grupi vlerësues pranë KLP-së ka analizuar 3 (tri) dokumentet e paraqitura nga subjekti dhe konkretisht:

i) vendimi për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2013, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁷⁹;

ii) kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2015⁸⁰;

iii) konkluzione përfundimtare të paraqitura përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për çështjen penale nr. *** të vitit 2014⁸¹.

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga subjekti, si dhe raportin e përcjellë nga KLP-ja, konkludoi se në tri dokumentet e paraqitur nga subjekti, nuk janë konstatuar problematika që të çojnë në një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit për sa i përket aspektit profesional.

18.3 Grupi vlerësues pranë KLP-së ka analizuar pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura me short, si vijon:

Dokumenti 1. Kallëzimi penal nr. ***, datë 30.8.2016, mosfilluar në datën 16.9.2016⁸².

Dokumenti 2. Procedimi penal nr. ***, datë 2.12.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, pushuar në datën 25.1.2016.

Dokumenti 3. Procedimi penal nr. ***, datë 10.10.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pushuar në datën 23.12.2014⁸³.

Dokumenti 5. Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***, regjistruar në datën 18.10.2013⁸⁴.

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga subjekti, si dhe raportin e përcjellë nga KLP-ja, konkludoi se në katër dokumentet e përzgjedhur me short, nuk janë konstatuar problematika që çojnë në një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit për sa i përket aspektit profesional.

18.4 Në dokumentin nr. 4. Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***, regjistruar në datën 9.10.2014, në ngarkim të të pandehurit E. Gj., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal. Në përfundim të gjyimit, në

⁷⁹ Vendimi për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2013, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë regjistruar në datën 23.12.2013, për veprën penale “mjekim i pakujdesshëm” parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal.

⁸⁰ Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2015, në ngarkim të të pandehurve K. K., i akuzuar për kryerjen e veprave penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake e municioneve” dhe “Prishjes së qetësisë publike” të parashikuara nga nenet 278/5 dhe 274 të Kodit Penal, F. Q., Y. Q., B. Q., D. Q., J. D., S. B., të akuzuar për kryerjen e veprës penale “moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe Sh. P., i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal.

⁸¹ Konkluzione përfundimtare të paraqitura përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për çështjen penale nr. ***, të vitit 2014, në ngarkim të të pandehurit A. Th., të akuzuar për kryerjen e veprës penale të “vrasjes nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal.

⁸² Në datën 16.9.2016 është vendosur “mosfillimi i procedimit penal për materialin kallëzues nr. ***, të vitit 2016”, mbështetur në nenet 24/2, 291 dhe 290/1/ç, të Kodit të Procedurës Penale, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Në vendim arsyetohet se nuk ka elementë të ndonjë veprë penale të parashikuar si e tillë nga Kodi Penal, ndaj në këto kushte duhet të vendoset mosfillimi i procedimit për kallëzimin e mësipërm

⁸³ Procedimi penal nr. ***, datë 10.10.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pushuar më 23.12.2014, regjistruar për veprën penale “goditje për shkak të detyrës”, të parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Y. K.

⁸⁴ Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. *** regjistruar, më 18.10.2013, në ngarkim të të pandehurit A. B., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal.

konkluzionet përfundimtare të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Marjeta Zaimi, datë 24.3.2015, është kërkuar: *“Deklarimi fajtor i të pandehurit E. Gj., për veprën penale “plagosje së lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal dhe dënimi i tij me 9 muaj burgim. Të mbahet parasysh nga gjykata përfitim i ligjor i të pandehurit nga aplikimi i nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale etj.”.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e datë 24.3.2015, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit E. Gj., për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 9 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale e dënoi me 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal pezullimin e dënimit me burgim dhe vënien në provë për një afat 18 muaj etj.”.*

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Marjeta Zaimi, nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës.

18.4.1 Komisioni ka konstatuar se nga subjekti i rivlerësimit në rolin e prokurorit të çështjes nuk është bërë ankim ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, e cila ka vendosur pezullimin e dënimit me burgim, vendim i cili ka qenë ndryshe nga kërkimi i prokurorit, duke pasur parasysh faktin që ndaj të pandehurit E. Gj., më parë gjykata ka lëshuar dy urdhra mbrojtjeje në favor të ish- bashkëjetueses A. T., vajza e të dëmtuarit V. T., për ushtrim dhunë në familje (dy vendimet e gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes të ndodhura në dosje).

Referuar konstatimit të mësipërm, subjektit iu kërkua të japë shpjegime në mënyrë sa më të qartë të përmbledhur bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

18.4.2 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar, ndër të tjera, se vendimi i gjykatës, e cila disponoi ndryshe në vendimin e saj, për sa i përket mënyrës së ekzekutimit të vendimit, ishte në përputhje me kriteret që parashikon neni 59 i Kodit Penal, fakti që plagosja e lehtë me dashje është kundërvajtje penale që ndiqet mbi ankimin e të dëmtuarit, ka çmuar se nuk duhej të bënte ankim ndaj vendimit të gjykatës, për sa i përket mënyrës së ekzekutimit të dënimit, sa kohë pranoi kërkesën për deklarin fajtor të të pandehuri E.Gj dhe dënimin e tij me burgim sipas kërkesës së prokurorit. Gjithashtu, edhe afati i provës prej dy vjetësh është i mjaftueshëm në funksion të efektit parandalues të të pandehurit, për të kryer vepra të tjera penale.

Subjekti ka shpjeguar, gjithashtu, se faktin që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar dy urdhra mbrojtjeje mbi kërkesën e shtetasës A. T., të cilat janë administruar nga subjekti në fashikull në kuadër të hetimeve të thelluara të kryera ndaj të pandehurit E. Gj., nuk kanë lidhje me objektin e gjykimit, pasi nga ana e të pandehurit nuk është shkelur vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes ndaj ish-bashkëjetueses së tij A. T., dhe nuk janë kryer veprime ndaj ish- bashkëshortes apo djalit të tyre, por vepra penale është kryer ndaj babait të ish-bashkëjetueses së tij, i cili është dëmtuar lehtë prej tij, por gjithsesi këto fakte janë mbajtur në konsideratë prej prokurorit në llojin dhe masën e dënimit të kërkuar ndaj të pandehurit E. T. Edhe nga drejtuesi i prokurorisë sipas ligjit të asaj kohe nuk është ushtruar e drejta e ankimit kur nuk bënte ankim prokurori i çështjes, duke e konsideruar të drejtë vendimin e gjykatës.

18.4.3 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se prej tij është bërë një vlerësim tërësor i fakteve dhe rrethanave, ku është arritur në konkluzionin se të pandehurit E. Gj., duhej t'i jepej dënimi me burgim dhe jo me gjobë, siç parashikohet në nenin 89 të Kodit Penal. Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar përse e ka konsideruar të drejtë vendimin e gjykatës për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal për pezullimin e vendimit me burgim dhe nuk ka shpjeguar përse nuk ka bërë ankim ndaj tij, kur vetë subjekti ka vlerësuar të japë për të pandehurin vetëm dënimin me burgim.

Komisioni vlerëson se mosankimimi i vendimit të gjykatës ka një peshë minimale dhe në vlerësimin tërësor të kriterit profesional nuk përbën shkak për vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit, për sa i përket kriterit profesional.

TË DHËNAT ARKIVORE (ankesat dhe masat disiplinore)

19. Referuar të dhënave arkivore pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore, për prokuroren subjekt vlerësimi Marjeta Zaimi, rezulton se ndaj këtij subjekti nuk ka masa disiplinore.

19.1 Nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave në Sektorin e Protokollit dhe Arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në gjithë prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, për prokuroren Marjeta Zaimi, rezulton se ndaj këtij subjekti nuk ka ankesa.

Nuk ka të dhëna apo informacione për cenim të figurës së subjektit të rivlerësimit, që të jetë përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, si dhe të dhëna për raste të identifikimit të subjektit të rivlerësimit për kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtar të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale), ku përfshihen edhe biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike.

19.2 Pranë Prokurorisë së Përgjithshme ka të dhëna për vlerësimin e punës së prokurores Marjeta Zaimi, të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 42, të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe urdhrin nr. ***, datë 19.11.2012 “Për miratimin e rregullores për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”, si vijon: Për vitin 2014, 2015 dhe 2016, subjekti Marjeta Zaimi është vlerësuar “*shumë mirë*” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, pasi detyrat e ngarkuara i ka kryer me cilësi dhe shpejtësi.

DENONCIMET NGA PUBLIKU

20. Ndaj subjektit e të rivlerësimit, znj. Marjeta Zaimi, është depozituar vetëm 1 (një) denoncim nga publiku dhe konkretisht: **denoncim me nr. *** prot., datë 24.12.2018, i shtetas Dh. K.**

Shtetasja Dh. K., ngre ankesë ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Marjeta Zaimi, për korrupsion dhe se prokurorja ka vendosur mosfillimin e procedimit penal padrejtësisht dhe pa u bazuar në prova dhe se gjykata e ka kthyer për rihetime të mëtejshme. Personat e kallëzuar kanë falsifikuar të gjithë dokumentacionin e pronës së R. K., nëpërmjet noteres V. S.

20.1 Komisioni ka administruar nga Prokuroria e Rrethit Tiranë⁸⁵ vendimin e mosfillimit të procedimit penal të vitit 2016 me kallëzuese Dh. K., vendimin e gjykatës nr. *** akti, datë 15.5.2017, vendimin e pushimit të procedimit penal nr. ***, të vitit 2016, si dhe vendimin e gjykatës nr. *** akti, datë 18.10.2017⁸⁶

⁸⁵ Prokuroria e Rrethit Tiranë me nr. *** prot., datë 17.7.2020.

⁸⁶ Ankuesja Dh. K., ka paraqitur në Prokurorinë e Rrethit Tiranë kallëzim penal ndaj shtetasve I. K., etj. për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm në pronën e saj. Pas veprimeve hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit, znj. Marjeta Zaimi (si prokurore e çështjes), në fund është vendosur: “*Mosfillimi i procedimit penal të kallëzimit nr. ***, të vitit 2016*”. Në marrjen e këtij vendimi subjekti ka argumentuar se: “*materiali nuk i plotëson kushtet për t’u regjistruar si procedim penal pasi mungon fakti penal. Rezulton se jemi përpara një marrëdhënie juridiko-civile ndërmjet denoncueses dhe personave të kallëzuar dhe për zgjidhjen duhet ti drejtohen gjykatës me padi civile*”.

Kallëzuesja Dh. K., nuk ka qenë dakord me vendimin e “mosfillimit” të prokurorisë dhe e ka ankimuar atë në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Gjykata me vendimin nr. *** akti, datë 15.3.2017, ka vendosur: “*Pranimin e kërkesës së kërkuases Dh.K. Shfuqizimin e vendimit të “mosfillimit të procedimit penal datë 21.9.2016, që i përket nr. ***, datë 23.9.2016, të Prokurorisë së Rrethit Tiranë dhe vazhdimin e hetimeve të mëtejshme*”⁸⁶.

Pas vendimit të gjykatës, subjekti i rivlerësimit ka vijuar me hetime të mëtejshme duke kryer një aktekspertim teknik, si dhe ka thirrur dhe pyetur shtetasit K. L., dhe R. J. Në përfundim prokuroria ka vendosur: “*Pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2017 pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale*”, me të njëjtat argumente që nuk

20.2 Komisioni, nisur nga pretendimet e denoncueset, si dhe referuar vendimit të gjykatës, e cila ka rrëzuar vendimin e prokurorisë për t'u kryer hetime të mëtejshme, pasi nuk janë kryer veprime të plota hetimore (si kryerja e një aktespertime teknik apo dhe thirrja dhe pyetja e personave të kallëzuar nga kallëzuesja Dh. K., për të arritur në konkluzionin se fakti i referuar nuk përbën vepër penale të dënueshme nga legjislacioni penal), kërkoi nga subjekti të japë shpjegime.

20.3 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se në këtë rast janë kryer vetëm veprime verifikuese të materialit kallëzues të regjistruar në prokurori dhe jo hetime të mirëfillta, pasi është gjykuar se nuk përmbusheshin kushtet ligjore për regjistrimit e procedimit penal. Edhe pas rrëzimit të vendimit të mosfillimit të procedimit penal nga ana e gjykatës, në përfundim të kryerjes së veprimeve të tjera hetimore, përsëri vendimmarrja (mosfillimi) përputhej me zgjidhjen ligjore dhe arsyetimin e subjektit, në vendimin e mosfillimit herën e parë. Rrëzimi i vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe urdhërimi i veprimeve hetimore nuk ka qenë efektiv, vetëm sa ka shtuar në kohë zgjidhjen e konfliktit civil midis denoncueses dhe shtetasve, të cilët sipas saj i kishin cenuar të drejtën. Pas kryerjes së veprimeve hetimore në vitin 2017 është vendosur pushimi i procedimit penal nr. ***. Pas ankesës përsëri të kallëzueses Dh. K., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendosi rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj, duke lënë në fuqi vendimin e prokurorit për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2017. Gjykata e Apelit Tiranë, pas ankimit të kallëzueses, me vendimin nr. ***, datë 21.12.2017, vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Subjekti thekson se veprimet e saj si prokurore kanë qenë të drejta dhe në zbatim të ligjit material dhe procedural.

20.3 Komisioni vëren se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me prishjen e vendimit nga gjykata. Fakti që gjykata e ka prishur vendimin e mosfillimit të dhënë nga subjekti për veprime hetimore të mëtejshme, nuk ka ndryshuar qëndrimin e subjektit, pasi dhe pas veprimeve hetimore të tjera subjekti ka arritur në të njëjtin përfundim. Ky qëndrim i subjektit është konfirmuar nga gjykata e rrethit në rigjykim dhe lënë në fuqi nga gjykata e apelit.

Komisioni arrin në përfundimin se nuk ka *indicie* apo prova për ta ngarkuar subjektin e rivlerësimit më përgjegjësi disiplinore për sa i përket kriterit profesional.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues i Komisionit

Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV, të nenit 51, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Marjeta Zaimi:

a. ka kryer deklaram të mjaftueshëm dhe në vlerësim tërësor, të saktë të pasurisë, duke u konstatuar pasaktësi të karakterit minimal;

Nga analiza financiare rezulton se me të ardhurat e fituara nga punësimi i saj dhe i personit të lidhur/bashkëshortit, ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të blerë pasuritë, për të krijuar likuiditetet dhe për të kryer të gjitha shpenzimet e jetesës të evidentuara gjatë periudhës së rivlerësimit 2003 – 2016, në shumën -1,001,382 lekë, të cilën Komisioni, në bazë të parimit të proporcionalitetit, e vlerëson si element të pamjaftueshëm, që mund të çojë në

janë konsumuar elementët e veprës penale të ndërtimit të paligjshëm parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal ndaj në këto rrethana duhet të vendoset pushimi i procedimit penal, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Kallëzuesja Dh. K., ka ankimuar përsëri vendimin e prokurorisë në Gjykatën e Rrethit Tiranë e cila me vendimin nr. *** akti, datë 18.10.2017, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj. Lënien në fuqi të vendimit të prokurorisë datë 31.5.2017, për pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2017”⁸⁶.

Pas ankimit të kallëzueses në Gjykatën e Apelit Tiranë, kjo e fundit me vendimin nr. ***, datë 21.12.2017, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. *** akti, datë 18.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

konkluzionin se ndodhet përpara një deklarami të pamjaftueshëm dhe, për rrjedhojë, në aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, referuar nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

- b. referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Marjeta Zaimi, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

Bazuar në këto konkluzione, si dhe nga vlerësimi tërësor i procedurave, në kuptim të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nga vlerësimi i secilit të të tria kriterëve:

- a. ka arritur nivel të besueshëm të pasurisë, duke përmbushur kushtet ligjore të germës “a” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas nenit 59/b të ligjit nr. 84/2016;
- c. konsiderohet “i aftë” në vlerësimin e aftësive profesionale, duke përmbushur kushtet ligjore të germës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të pikës 1/a të nenit 58 dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Marjeta Zaimi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 16.2.2021

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese (kundër)

Olsi KOMICI
Relator

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj